

Kjo bisedë me Stefan Çapaliku, shkrimtar, dramaturg dhe poet lidhet përmasën e tij si poet pasi pas tre dekadash, ai vendosi të botonte një libër me poezi, "Camera Obscura".

## STEFAN ÇAPALIKU

### Janë përmbajtjet e reja ato që do të më çojnë drejt formave të reja

Bisedoi *Andreas Dushi*

**"ExLibris", Ben Blushi dhe Maringlen Kasmi janë fituesit e edicionit të parë të çmimit "Sami Frashëri" dhënë nga Bashkia e Belshit**

#### SHËNIME MBI LIBRAT

"Polemikat" e Uran Butkës

#### HUMNERA E SHKRIMTARIT

Nga *Astrit Delvina* (fq. 4)

Shënime për vëllimin poetik të Kujtim M. Shalës

#### "IDIOMA" E KUJTESËS

Nga *Prof. Asoc. Elsa Skënderi* (fq. 6)

Romani "Dashnorë në çmendinë" i Kosta Limburis

#### Letërsi e dramës historike dhe e dëshpërimit shoqëror

Nga *Petro Çerkezi* (fq. 8)

Mbi librin "Dritë në lëkurë" të poetes Sabina Darova

#### DRITA E FUNDIT E MUZGUT

Nga *Dhimitër Pojanaku* (fq. 9)

"Porosia e kullës" e autorit Pashko R. Camaj

#### KTHIM NË VENDIN E ORIGJINËS SI KËRKIM I KUPTIMIT TË JETËS

Nga *Zija Vukaj* (fq. 10)

Shënime për librin "Fjalët që shihen dhe gjumi në shtëpinë e pritjes"


#### FJALËT QË PI DHE SHEH THANAS DINO

Nga *Enver Kushi* (fq. 12)

Shënime për romanin "Briret", të Marash Mirashit

#### Republika surreale e barinjve

Nga *Merita Gruda* (fq. 13)



Ilustrimi nga Ina Lajthia



Foto nga Luka Mjeda

Në numrin e fundit të revistës së madhe italiane "50 & PIÙ" - tetor 2024, është botuar një intervistë e tij, dhe shkrimtarit Visar Zhiti

## VISAR ZHITI, POETI QË KA SFIDUAR REGJIMIN...

Intervistë e gazetarit italian

Renato Minore

Libri më i fundit i Visar Zhitit është një koleksion i mrekullueshëm i poezive, "Rrugë që rrjedhin nga duart e mia", (publikuar nga shtëpia botuese *PuntaCapo*, përkthimi i Elio Miracco-s), të cilit i është ndarë çmimi ndërkombëtar i poezisë.

### NË NDER TË SYLVIA PLATH

Nga *Melody Cui*

Përktheu Jola Tasellari (fq. 21)

### FUQIA E LETËRSISË dhe të jesh shkrimtar në "Epokën e ankthit"

Revista letrare Lithub

Përktheu: Granit Zela



(fq. 22)

#### BIBLIOTEKË

Besnik Mustafaj (fq. 14)

*Zbulimi i Amerikës nga shqiptarët*

Sokol Zekaj (fq. 16)

*Koha e qytetit*

Biser Mehmeti (fq. 17)

*Fëmija pa emër*

Sazan Goliku (fq. 18)

*Këngë pleqërore ose vargje të ngrira*

Luljeta Dano (fq. 19)

*Buka e përditshme*

Arben Meksi (fq. 20)

*Karikatura e së shtunës*

### PAUL ELUARD

*Liri* (fq. 23)

Përkthyer nga, dhe shoqëruar me fotografi të Prof. Dr. Bledar Kurtit

### EKSTAZA SOMNAMBULIKE E TË LEXUARIT

Përshkrim nga *Xhevair Lleshi* (fq. 11)

Kjo bisedë me Stefan Çapaliku, shkrimtar, dramaturg dhe poet lidhet përmasën e tij si poet pasi pas tre dekadash, ai vendosi të botonte një libër me poezi, "Camera Obscura".

## STEFAN ÇAPALIKU:

# Janë përmbajtjet e reja ato që do të më çojnë drejt formave të reja

*Bisedoi Andreas Dushi*

Pas thujse tre dekadash, Stefan Çapaliku rikthehet te zhanri i parë i krijimtarisë së tij: poezia. Libri i '94, "Kohë e ndalur" rifillon si kohë poetike në vëllimin e ri që u promovua para pak ditësh në Tiranë dhe në Shkodër. Aty edhe e takoj, në qytetin tonë të lindjes, ku më pret diku pranë shtëpisë së dikurshme, mbi të cilën tani është ngritur një pallat i madh. Pasi përshëndetemi dhe ulemi, e pyes me shumë kureshtje se pse vendosi të botonte poezi në këtë kohë? Çfarë e shtyu?

"Atë që më shtyu po kërkoj e s'po e gjej..." - fillon përgjigjen me shaka. "Përtej humorit, mundem me thanë se poezia vjen te ai që e pret. Dikur mendoja se poezinë ti thjesht e "gjuan", si një emocion kalimtar, që ikën njëherë e përgjithmonë, si një kafshë e egër në pyllin e dendur të jetës. Në të vertetë te unë nuk ka ndodhë kështu. Poezia ime ka qenë gjithnjë atje, mes mundësive narrative, dhe ajo thjesht po stagjionohet si një venë e mirë, e mirë, e mirë."

Kësisoj kam shkruar një libër që s'kam mundë të mos e shkruaj. Kam shkarravitë një libër duke qenë i mbushur me dyshime, që kohët e fundit më kanë vizituar nga të tana anët. Kam kurdis një libër gjatë kohës kur jam ndërës si fotograf, me kryet e zhytur në një thes të zi, që ishte paradhoma e një kutie të errët. Brenda kësaj kutie më është përmbysë bota, më kanë bërë kotullumba imazhet."

Biseda vijon normalisht. Sapo ndez cigare, ja drejtoj edhe atij, por më thotë se tash dhjetë vjet nuk e pi më. "E lashë njëherazi me mësimdhënien", vijon.

Më duket pak i komplikuar personaliteti i tij shumëpërmasor. Është e pamundur ta përfshish atë në vetëm një emërtim, qoftë ky edhe shkrimtar; ai e tejkalon. Kam ndjekur shumë nga dramati dhe komeditë e tij e po ashtu, kam lexuar thujse të gjithë romanet apo përmbledhjet me tregime që ka shkruar. Lexuesi dhe publiku, pavarësisht mënyrës se si Çapaliku i ofrohet, e mirëpret përherë.

E bezdis ndopak lëvizja në të tre zhanret letrarë, nga drama te proza dhe te poezia? Po angazhimet e fundit, ajo e mbledhjes dhe botimit të një sërë barcaletash si dhe, para dy muajsh, antologjia e kulinalirisë në letërsinë shqipe ku është bashkautor, e kanë ndikuar disi procesin e tij të shkruarit?

"Aspak!", thotë me bindje. "Është një lojë e mrekullueshme. Është interesant se tek grekët e vjetër fjala 'art' është shprehur me fjalën 'techno', pra teknikë dhe në Lindjen e Largët, konkretisht në Japoni, fjala 'art' ka dashur të thotë 'lojë'. Ja pra ku i kemi të dyja konceptet: lojë dhe teknikë. Hyr në lojë dhe njih teknikat, kjo kishte me qenë moto. Në këtë kuptim unë jam një lojtar që i përdor të gjitha teknikat, që mendoj se mund të më çojnë drejt fitores..."

Letërsia e Çapalikut e tërheq vëmendjen e lexuesit për një sërë arsyes. Mua për shembull më tërheq shumë sinjeriteti i saj: Personazhet nuk ngurrojnë të jenë të vërtetë, aq sa ndonjëherë mund edhe të duken si

naivë, paçka se vetëm të atillë nuk janë. E kam pyetur shpesh si i portretizon personazhet, nga e merr lëndën e parë etj., prandaj tani, me cigaren e dytë të fikur përmbi tavëll, i flas pak për poezitë e vëllimit të tij të fundit.

Ndërthurja e tematikave bën të mundur që poezitë të përfaqësojnë një kontekst aq të gjerë sa vetë njeriu, jeta e tij në të trija kohët, si meditim, përsiatje dhe shpresë. Çapaliku, me kujdes e zgjedh secilin varg për të tejçuar

bashkë me ndjeshmërinë, edhe pamjen e asaj ndjenje që në vetvete e balsamos çastin e zënë thujse në grackë, pasi duket se ai çast përballë kthimit në përjetësi falë poezisë është i papërgatitur dhe i befusuar. Kështu, i mungon koha ta përsosë veten dhe lënda estetike e poezisë mbetet krejt e natyrshme, pa asnjë mbi-apo-nën-vendosje zbukuruese.

Qyteti, urbanja nuk mungon as ndër to. "Dakord", më thotë, por për cilën e ke fjalën

konkretisht? Po ja, dhe hap librin në faqen 36 ku filloj të lexoj *requiem për franz jozefin*:

*requiem për franz jozefin*  
thonë se perandori franc jozef vdiq  
në shtrat  
në dhomën e vet të madhe  
në shënbrun  
rrethu prej gjithë shpurës perandorake  
diku në vitin 1916

kurse franz jozefi im u zhduk për një natë  
në të zbardhun të një dite pa datë  
njqind vjet ma vonë  
ndoshta në vitin 2011  
i parrethuem nga askush

edhe pse një shekull larg  
të dy kishin kohë që rënkoinin  
kishin vite që dergjeshin

i braktisun atje  
në mëshirë të fatit  
diku në derdhje të lumit bojana  
atje ku delta asht një sqep zogu  
i hapun prej dhimbjes  
franz jozefit tim i qe hollu beli  
i qe tretë shikimi  
i qe shkimë durimi

ndjej se dikush ma hangri ishullin tim  
andaj rri dhe e kërkoj me sy  
në barqet e gjithë atyne  
që e jetuen epokën time  
shëndosh e mirë

prandaj jam i bindun se ishulli gjendet aty  
te zorrët e trasha të të gjithëve ne  
që e jetuem vitin 2011  
si të qe një vit i zakonshëm

franc jozefi im  
kish pritë që dikush ta shpëtonte  
ndaj dhe kishte vite që e kish lëshu  
sinjalin sos  
por të gjithë kujtuen se ai po llastohet

fatkeqësisht ndër kronikat e zeza  
askund nuk gjendet e shkrueme se  
më 2011 deti mizor gllabëroi një ishull


deti  
edhe pse nuk qe i uriturun  
e hangri ngadalë  
madje pati nge edhe me e ripërtypë  
bashkë me pemë  
me rranjë  
leshterikë  
dhe dëshira e andrra të fshehta  
që dashnorët kishin belbëzu  
kur kishin shkelë mbi të

nuk e di se pse imagjinoj që  
ishulli im vdiq ditën kur  
njerëzit nëpër botë qenë të habitun  
se marinsat amerikanë  
patën vra osama bin laden  
se kish shpërthy pranvera arabe  
se estonia zyrtarisht adoptoi  
monedhën euro  
se mori fund referendumi  
për pavarësinë e sudanit  
se india fitoi kupën e botës në kriket  
se festivalin europian e fituen  
kangtarët nga azerbajxhani  
se dha dorëheqjen  
presidenti hosni mubarak  
se tomas tranströmerit iu dha çmimi  
nobel

ndërkohë që ndodhnin këto e të tjera  
uji i ish ofru te goja francit tim  
ndërsa po fundosej bashkë me flokët e vet  
të gjelbër  
shpresën ngjyrë rane  
dhe tana mallkimet e zotave

Ja, kjo për shembull... Pse vendos ta  
përshkruash nëpërmjet lirikës poetike një  
subjekt që fare mirë do t'i shkonte edhe një  
tregimi?

"Se lënda më paraqitet si likuide, një  
materie e shkrifët, shpesh e lëngshme, që



mund të derdhet ndër tasele të ndryshme dhe të japë rezultate të ndryshme. Mandej shkrintari është një qenie në palestër. Varet shumë se cilën vegël është duke përdorur më shumë në ato ditë.”

Çapaliku këtë libër e ndan në cikle dhe, sikurse jo rrallë herë në letërsinë e tij, kujtoj këtu për shembull “Secili çmendet sipas mënyrës së vet”, *Stefani familjarisht* është i pranishëm, sidomos në ciklin *libri i shpisë*. I kërkoj leje t’i lexoj poezinë *elit* dhe atë mbasardhësen, *nana angje nuk besonte radio tiranën*.

elit  
fëmijë  
ishim veç një vizatim  
nji skicë e thjeshtë

ishim një shenjë që gjithkush  
mund ta fshinte  
e vizatueme në fletoren e gjetun  
te hymja e një shkollë

le të dukej ashtu  
si një shkarravinë ajo shenjë  
por ishte e bame prej ne të dysh  
kur po dilte pranvera

ne donim që vizatimi  
të mbeste ashtu

dy vija që takoheshin vetëm  
po t’i zgjasje  
por ne nuk i zgjasnim dot  
se ne qenë dy fëmijë  
që nuk zgjatëshin

mësuesja u shqetësu shumë  
se pse ne nuk po zgjatëshim si të tjerët

mësuesja donte që ne të zgjatëshim  
e ta preknim njeni tjetrin  
si dy vija që zgjaten  
si dy vija që takohen  
e mandej  
si dy vija që shkojnë  
secila për hesap të vet

po ne nuk donim ta shkarravisnin  
jetën tonë  
që aso kohe ishte thjeshtë  
veç dy vija të vogla  
të bame prej nesh vetë

ne donim vetëm që  
askush të mos e prekte  
fletoren tonë të vizatimit

ne kurrë nuk e morëm vesh se pse  
dikush kërkonte që të rriteshin  
ç’ ishte ky ngut

nana angje nuk besonte radio tiranën

edhe pse radio tirana  
fliste çdo mëngjes për motin  
nana angje nuk besonte  
veç shikonte nga dritarja  
oborrit e reshkun  
prej murrllanit  
hardhitë e ngërdheshuna  
nji shegë të përdredhun n’kryq  
e nuk di se çka tjetër

ndoshta pusin  
që rrinte i shtangun  
me një kovë në ijë  
dhe gjethet e shermashekut  
që ende nuk e kishin sosë  
murmurimën e natës

asht ftohtë thoshte ajo  
duhet me u veshë trashë

dhe na bante shenjen e kryqit  
para se të na përcillte për shkollë

Sa e rëndësishme është historia e individit në mburrtjen e lëndës poetike, e pyes sapo përfundoj leximet.

“Historia e individit është gjithcka. Ne e jetojmë botën në dy rrafshë: imediate dhe mediatike. Sigurisht që eksperiencat



Foto nga Luka Mjeda

imediate kanë më shumë gjasa të prodhojnë art, për shkak të karakterit mimetik të artit, por nga ana tjetër ne mund të shkruajmë poezi edhe për realitete që na vijnë pranë në kanale mediatike dhe që nuk i kemi takuar kurrë fizikisht.”

Në librat e tij ekziston edhe standardi, edhe gegnishtja, edhe bashkimi i të dyjave. Ndonjëherë, për këtë fakt merr edhe vërejtje, prandaj jam kureshtar ta di se në dizimin që ajo ofron, si gjendet autori? Po zgjedhjen se cilin të përdor, si e kryen?

“Përpiqem të jem i vëmendshëm,” thotë, “ndaj zhvillimeve gjuhësore. Zhvillimet gjuhësore në Shqipëri nuk janë as në duart e gjuhëtarëve dhe fatkeqësisht as në duart e shkrintarëve. Me librin tim më të fundit kam propozuar një koine gjuhësore, e cila mbështetet kryesisht në dimensionet liberale të gegnishtes.”

Në bisedë e sipër, i kthehem një interviste tjetër që i kam bërë profesorit po në ExLibris pasa dy vjetësh. Titulli i zgjedhur prej meje nga përgjigjet e tij, “Drama është zhaner politik!”, mori ndonjë kritikë jo fort dashamirëse. E tejkaloj këtë ama pasi është krejt e parëndësishme. Vazhdon të mendosh kështu, e pyes. Patjetër, përgjigjet.

Po mirë atëherë, po poezia? Çfarë zhanri është poezia?

“Mendoj se poezia është zhanri më i papërpunuar letrar. Një fazë parake e ekspresioneve estetike, shpesh intuitive dhe e pakrahueshme për nga struktura dhe projekti me prozën e gjatë dhe sidomos dramën. Ajo është shumë më tepër dëshmitare e shpirtit sesa e mendjes.”

Nuk besoj se në krijimtarinë e Çapalikut gjendet një fragment që t’i përshkruaj më mirë personazhet e tij sesa poezia që i ka dhënë titullin librit, *Camera obscura*. Po, i rikthehem sërish temës së personazheve, pasi më intereson veçanërisht, për shumë arsye. Autori e tejkalon kthimin e njeriut të zakonshëm në *hero* të veprës; ai është më shumë se aq: është koha e veprës, subjekti i saj... është vetë natyra e tekstit!

camera obscura  
I  
dhe i thirra të gjithë të fotografoheshin  
ma të parët ahengxhitë me vegla  
e mandej berberët  
biçiklistët  
bojaxhinjtë  
bozaxhinjtë  
fotografët vetë  
hidraulikët  
këpucarët  
tavapjekësit  
rrobaqepësit  
lustraxhinjtë  
marangozët  
radioteknikët dhe saraçët  
shtypshkruesit gjithashtu  
mbas fotos  
do pijmë derisa të vdesim i thashë  
të gjithë njëherësh  
si një kooperativë e madhe  
artizanale  
qyteti nuk ka ma nevojë për ju

asnji nuk foli  
mbas kësaj  
askush

heshtjen e thyen ahengxhinjtë  
që i akorduen mirë veglat  
zejtarët e tjerë qëruen zanet  
ishte një kor i mrekullueshëm

shikohej qartë  
se të gjithë kërkonin  
nji vdekje të përsosun  
jo si qyteti

Mendoj me vete se po të mos kishte ndjekur këtë rrugë, ka të ngjarë të ishte bërë fotograf. Nuk ja them, ama gjetja e mënyrës së fotografimit nëpërmjet poezisë ma forcon këtë ide. Vendosi mos ta zgjas dhe i rikthehem diskutimit mbi poezitë e tij.

Renditja njëra pas tjetre e dy poezive, *dhomat e hoteleve* dhe *pafajsia ime* e bëjnë krejt të qartë se poezitë nuk janë vënë në libër as sipas një rënditjeje kronologjike, as pa një rënditje të brendshme. Për këtë, Stefani më thotë...

“E vertetë,” pohon. “Me rastin e botimit të këtij libri kam dashtë të eksploroj disa përmbajtje të reja që më kanë rrethuar, me shpresën se janë përmbajtjet e reja ato që do më çojnë drejt formave të reja.”

Po bëhet vonë e afron orari i drekës. Pasdite do të jetë promovimi i librit në kinema “Republika” të Shkodrës. Autori e ka konceptuar krejt ndryshe, si një video-performancë. Nga të erdhi kjo ide? Dhe si lidhet ajo me librin?

“Duke qenë se kam hartuar një libër ku autori i ngjan atij kalimtarit të vetmuar që zbulon, përndjek, lundron në ferrin urban dhe që e zbulon qytetin si një peizazh veshesh epshore, kam vendosur t’a imitoj këtë estetikë edhe në mënyrën e promovimit të tij.

E di se të fotografosh njerëzit do të thotë t’i dhunosh ata... prandaj personazhet e mi nuk i kam vu kurrë që të marrin pozë. Kësisoj kam fiksua energjinë e pakontrollueme, dinamikat e lëvizjes dhe shpesh edhe situatat e tyre karikatueske.

Siç thotë Susan Sontag te libri i vet mbi fotografinë “Aparati fotografik asht një sublimim i armës, të fotografosh dikë është një vrasje e pandërgjegjshme, një vrasje e butë, e përshtatshme për një kohë të trishtuar dhe plot ankth...”

Po mirë, profesor, i them kur tanimë jemi në këmbë dhe po ecim një copë rrugë bashkë: Çfarë ndjen që ju riktheve poezisë? Sikur gjete dashurinë e dikurshme? Apo metaforë e lodhur kjo... Mos vallë, ta paktën, ndihesh prap po aq i ri sa kur ke shkruar poezi së pari?

“Sikurse e thashë edhe në krye është kryesisht një libër mendjeje, në kuptimin që nuk ka shumë lidhje me moshën. E kam zgjedhë me ndërgjegje këtë rrugë duke dashtë t’i shmangem sa ma shumë që të ishte e mundun poezive sentimentaliste, erotike dhe qarramane, territore në të cilat janë arritë rezultate të jashtzakonshme dhe të pakapërcyeshme.”

Ndahemi, secili në dy anët e rrugës përballë kishës françeskane, njëri për nga pedonalja e tjetri për në G’juhadol. Jam i sigurt se rrugës shoh disa prej atyre që janë në *Camera Obscura* të Stefanit. Ndonjëri më përshëndet, ndonjërin e përshëndes.

Ulem të pres dikë përballë katedrales. Përpara syve më kalojnë gjithë ato nana angje që në ballin e tyre dhe në atë të ndonjë nipi a mbese bëjnë shenjen e kryqit, duke shtrënguar me dorë tjetër kryqin e arit të varur në qafë. Po ashtu, fëmijë të kapur për dore, të rinj që puthen pa ju fshetur askujt, turista këmbëzbathur me çanta sa gjysma e shtatit të tyre. Secila tipologji e personazheve që diskutova me profesorin, me ndonjë element të shtuar, gjendet kudo nëpër qytet, veçse duhet pak vëmendje t’i shohësh. Dhe unë e ndjej se Shkodrës, sado përpiqem pambarimisht t’ja shuaj në atë dritë që lidh të shkuarën me të tashmen, në rituale të vogla, në sjelljet më të parëndësishme, filli i dritës vazhdon të jetojë. Veç në atë çast, dy vargje nga *tranzicion* marrin përnjëmend kuptim: *ndër bulza të kujtesës së mbetur/ gjetëm skicat e prjekteve ma të reja*.





“Idioma” është vëllimi më i ri poetik i studiuesit, kritikut Le poetit, Kujtim M. Shala, botuar nga shtëpia botuese “Dukagjini”. Filli tematik më i dukshëm i këtij vëllimi është lufta e fundit e Kosovës dhe kujtimet e saj. Kush e ka të njohur korpusin poetik të Shalës, tek endet në rrjedhat biografike të leximi të teksteve, do të shquajë se në të ri të poetit, fill pas luftës, ky korpus pak gjë thotë për luftën. Ajo më tepër shfaqet si konceptim kozmologjik përplasjes e rragimesh dashurore, se sa si përjetim jetësor konkret i ngjarjes historike. Rishtazi, duke iu larguar asaj në kohë, poeti i rikthehet ta këqyrë atë përvojë të rëndë. Duket se brami i kujtimeve të luftës tashmë i ka rënë për fundi shpirtit të subjektit poetik. Gjërat e rënda duan kohë për t’u fjalësuar, tmerret e persekucionit një gjuhë krejt më vete, do të thoshte dikur Primo Levi.

Libri ka tri pjesë “Idioma”, “Shpina” dhe “Lëkura”, secila e përbërë nga cikle poetike poema dhe poezi të mëvetësishme. Pezullia e ftohtë dhe kujtimet e thikta të luftës nyjtohen në mënyrë origjinale nëpër poemat e ciklet poetike të librit, duke e skalitur qartë kujtesën artistike për të djeshmen e mugët. Kritiku i mirënjohur, Harold Bloom, do të shkruante se: “Teksti poetik, teksa unë e interpretoj, nuk është një përmbledhje e shenjave në letër, por një betejë psikike, në të cilën luftojnë forcat autentike për të vetmen fitore, që ia vlen të korret, për triumfin profetik ndaj harresës”. Në vëllimin poetik “Idioma” beteja e të thënit dëkta në mënyrë autentike, për ta mposhtur harresën, është fituar.

Stili narrativ i poezive i bën ato të dallojnë nga veprat e mëparshme poetike të autorit. Rrëfëhet me vargje, që zënë njëri-tjetrin në kapërcyell sintagmash dhe që ndonëse priten, rrëfëjnë thuajse si në prozat poetike. Vargjet janë pa shenja pikësimit, pa ngarkesa figurative dhe një gjuhë e saktë deri në dhimbje e kumton poetikisht absurdin e ardhjes së një lufte të pakërkuar nga askush përpos barbarëve, ankthin e eksodit, sprovën e të marrit të armës si ushtar - pa qenë asnjëherë më parë i tillë - për ta mbrojtur dheun e lashtë, dhimbjen e djegies së gjithë ç’është quajtur shtëpi, kobin e vdekjes së të pafajshmëve, shuarjen e luftëtarit të fundit, ditën e parë pas luftës, listat me heronj e qyqarë!

Pragu i luftës jepet kështu:

*Qyteti duket i rruhosur i mbledhur në vete i vjetër sa dheun njerëzit e shikojnë me frikë si të shikonin fundin e tyre të zi shkëlqimi i thikës së xhelatit pret pamjen e rrugëve të qytetit askush nuk mund të kthehet më në shtëpi atyre rrugëve kopshiti i vjetër i shtëpisë së re është bërë djerrinë shtëpia e re ka zot të dhunshëm me sy të përgjakur barbar që do të mbrojë plaçkën e rrëmbyer si jetën e tij të ndyrë*

(Stacioni i vjetër II, 12)

Tmerrit të luftës, që troket, nuk i duhen vargjet e konotuara skajshëm. Thatësia e atij tmerri ndihet e rrëfëhet edhe përmes një fraze si “shkëlqimi i thikës së xhelatit pret pamjen e rrugëve të qytetit”.

Në poezitë e kësaj natyre funksionalizohet përmasa dokumentare (përmes fiksionit) e përvojës kolektive traumatike të luftës - të shkruarit mëton ta përkapë kujtesën, atë që sipas poetit “ngadalë e zënë mjegullat e hirta pastaj e zë errësira” (f. 34), ta rrokë që ajo të mos fluturojë veç në rrëfimet gojëtare, por të mbesë, të fiksohet në anale të letërsisë, edhe ngase ato të historisë, ndonjëherë mund të jenë të fryra me emra heronjsh të rremë, shkruan poeti.

Poezitë e ngulitin në truallin metafizik të fiksionit gjithë ç’duket se është bjerrë e tretur në rrjedhë të kohës: konturet e dikurshme të shtëpisë së fëmijërisë, që gjatë luftës u dogj, duke lënë pas veç gjurmën e dheut të djegur, linjat e fytyrave të njerëzve të dashur, jehun e fjalës me vend e me peshë të gjyshërve të shuar, peizazhin e udhës së fshatit, të zhbërë prej rrënimit të luftës.

*harta që nuk e fshiu koha as ujërat as dimrat e zi tregon ku ndodhej shtëpia e vjetër një vrugë e bërë në dheun e zi të tokës së lashtë harta e vendit që braktisën kur u larguan nga aty nën rrebeshin e plumbave rrënimin e armëve hijen më të zezë të urrejtes për ata që ishin në tokën e tyre [...]*

(“Idioma”, II, f.22)

Të gjitha shenja e kujtime për t’u fiksuar “në kujtesën e gjerë të njerëzve të disa brezave” përmes poezisë, që te tabula e secilit lexues e ngul një gozhdë, ku varet zhguni memorial i eksodit dhe i luftës dhe kujtimet për përjetimet e ankthshme, të tmerrshme e tragjike.

Fytyrat janë ngrirë nga frika dhimbja i ftohti i pranverës së hershme të moshuar që kanë zënë një cep me këmbët në baltë shpinën mbështetur në mur fëmijë që qajnë një lot i ngrirë në cep të qepallës dhe gjiri i nënës së re nuk pikon nuk rrjedh rrugën ia ka prerë frika për fëmijën nën shkëlqimin e ftohtë të thikës së xhelatit të tjerë që kanë hequr dorë nga vetja

Shënime për vëllimin poetik të Kujtim M. Shalës  
Botime Dukagjini

# “IDIOMA” E KUJTESËS

nga Prof. Asoc. Elsa Skënderi



jeta u rrjedh si në një ekran të zi që shton acarën e stinës armike

treni nuk vjen të gjithë e presin dritën në fund të tunelit drejt fundit të jetës

rrugëtimin që shuan atdheun jetët që thuren ditë pas dite me dashuri

(Stacioni i vjetër, II, f.12)

Në paradigmen e poezisë për luftën bën pjesë edhe poezia e dëshmisë, ku subjekti poetik është dëshmitari i drejtpërdrejtë i ngjarjeve të saj. Këtë tip të poezisë e hasim edhe te “Idioma”. Subjekti poetik e ka përjetuar vetë luftën, por asgjë në poezi nuk ka tonet e larta heroike a deklamative për pjesëmarrjen në luftë, megjithatë fushëbeteja paraqitet si ëndërr dhe ideal i epërm moral, jo për heroizëm si qëllim në vetvete, por për dinjitet sipas botëkuptimit autentik të vendit të lashtë.

burrat të zënë si në kurth për herë të parë ëndërrojnë të vdesin

në fushëbetejë ajo është lavdia edhe kur vdes i pari kur vdes bashkë me të tjerët vdes pa ikur nga fushëbeteja (Stacioni i vjetër, VI, f. 16)

Ndërsa, pas përfundimit të luftës subjekti poetik i neverit qyqarët, që rëndin të marrin vendin e heronjve, sepse heronjtë (e vërtetë) janë veç ata që ranë në luftë. Lavdia iu takon atyre!

Që nga lufta kanë kaluar vite e mbase koha i ka shëruar disa plagë, ndaj në vëllimin poetik edhe lamenti elegjiak është i përkorë, ndonëse trishtimi është përthekues, vuajtja e pamohueshme. Lufta, që ka shembur strehët identitare, botën me trajtat e veta origjinale, ka marrë edhe të pafajshmit.

Ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç kur u vra ditë vere tmerruar prej vapës po kalonte rrugicën e fundit për të zënë derën e shtëpisë nuk pa njeri dëgjoi të shtëna të gjata nuk ndjeu asgjë iu këputën këmbët drita e bardhë e dheut të tij u errësua ngadalë gropë u bë në sytë e tij qielli u nxi ra përmbys përmbyti të gjitha pamjet të gjitha kujtimet ai ishte luftëtar më i ri më i pafajshmi atdheun e njihte në trajtën e shtëpisë së tij në fytyrën e prindërve dhe të motrës[...]

(Idioma, XV, f. 41)

Kundërvëniet e së bardhës dhe së zezës, të dritës dhe të errësirës, ngricës dhe zjarrit, heronjve dhe qyqarëve, të jetës dhe të vdekjes, janë të parapëlqyerat e poetit, që realizojnë kontrastet e thella e mbresëlënëse në poezi, duke evokuar imazhe tronditëse, të tilla që, si në rastin e poezisë së mësipërme, bëjnë që mu përpara syve tanë të shfaqet çasti i kobshëm i shuarjes së dritës së 16-vjeçarit të pafajshëm, të rënë për atdheun që njihte në trajtën e shtëpisë së tij.

Një idiomë, shumë nivele leximi

**Idioma si verb identitar dhe etik**

Vetë titulli i përmbledhjes “Idioma”, për shkak të semantikës së fjalës, në makrostrukturë sugjeron disa nivele të leximit të tekstit, të cilat mandej shpërfaqen nga njëra poezi te tjetra. Idioma është gjuha e përbashkët e gjuha vetë - kujtesë e përbashkët (Humboldt-i do ta cilësonte shpirtin e një kombi). Kësisoj “Idioma” shfaqet si verb identitar.

Në poemën “Stacioni i vjetër”, që çel pjesën e parë të librit, zhvendosja me përdhunë e njerëzve, për shkak të luftës, shënon aktin e zhbërjes së identitetit, të rrëgjimit të qenësisë dhe të individualitetit. Individit përball me zvetënimin e shumëfishtë. Pahiri bëhet është pjesë e masës amorfë të një turme ikanakë, fatkeqe e të terrorizuar. Mandej tëhuajtet dhe nga një njeri me emër të përveçëm (kujtesë, rrënjë, histori, gjuhë, identitet) bëhet një “përemër”, njësi quajtëse zëvendësuese (pa semantikë, pa motivim gjuhësor e identitar, përpos motivimit referencial).

Treni merr turmën e parë nën çjerrjet e xhelatit niset drejt jugut

kur mbarojnë binarët e tij njerëzit humbasin veten nuk njihen më


kartat e identitetit shqyhen si fytyra të zbehta emrin e kanë

vetëm për vete i presin emra të rinj pa shenja kujtimesh emrat

që do t’ua vënë të tjerët me përçmim si nofka njerëzish fatkëqij

treni tjetër merr turmën e radhës të gjithë emrat kthehen në përemra në një në të cilën nis errësira dhe harrimi i zi

(Stacioni i Vjetër, V, f. 15)











Shkenca e klasifikimit apo "taksonomia" ka raste që bëhet faktor përcaktues në orientimin e vlerësimeve për një vepër. Por ka edhe raste kur një vepër e arrirë i fshin kufijtë taksonomikë dhe "rrengu" i klasifikimit zhbëhet. Ky mendim zë fill e ngjizet pas leximit me një frymë të librit "Porosia e kullës" të autorit Pashko R. Camaj. Kjo për arsye se po ta klasifikojmë këtë vepër, do ta fusnim menjëherë në një zhanër autobiografik, ku edhe qëndron me të gjithë elementët që kërkun ky klasifikim. Pra, një autobiografi, një roman autobiografik, një libër me hapësira të mëdha memuaristike, një kronikë jete individuale në sfondin e kohës dhe të hapësirës së vet etj. Por, a ia jep hakun ky klasifikim librit "Porosia e kullës", universit të kësaj veprë? Apo ia redukton hapësirat, duke e konsideruar vetëm një narrativë personale? A e tejkalon vepra me arsenalin ontologjik, me mesazhe dhe rrezatim universal, tejhapësinor e madje edhe tejkohor që përmban cilësimin si libër autobiografik? Patjetër që e tejkalon këtë cilësim. Natyrisht, që ky libër nuk duhet as mund të perceptohet me anë klasifikimesh tautologjike. Në këtë rast na vjen në ndihmë porosia e zgjuar e një dijetari të vjetër mistik që shprehej: "O jeto një jetë që meriton të shkruhet; o shkruaj një libër që meriton të lexohet." Dhe në rastin tonë, të dy krahet e këtij postulati pasqyrojnë esencën e këtij libri, për arsye se jeta e protagonistit-autor, paraqitur me mjeshtri, art, frymëzim, emociion dhe empati të thellë përmban më shumë se një jetë njerëzore. Duke kapërcyer personalen e duke fituar një karakter përgjithësues bëhet një shumatore fatësh të individëve të panumërt, rrugëtuesh dhe dramash të ngjashme apo të njëjta, në dritëhijet e një kohe dhe vendi plot brenga e pak gëzime, plot vuajtje në kufijtë e mbijetesës dhe shpresa e përbashkët për rrugëdalje thuasje mbinjerëzore. Duke u pozicionuar fort brenda unit të vet, siç ndodh në të gjitha rastet autobiografike, këndvështrimi i autorit Camaj bëhet dorës introspektioni i çdo lexuesi, sidomos i lexuesve që në formimin e tyre shpirtëror e kulturor kanë spikamat e miteve obsesive tashmë të universalizuara, pasqyruar së pari të narratori, siç janë Malësia, Liqeni i Shkodrës, Kulla, Kulti i babait etj.

Pra, autobiografizmi këtu nuk është qëllim- thjesht është mjet. Një mjet kompozicional mjaft i fuqishëm dhe efikas, pasi dihet efekti i fortë emocional që transmeton veta e parë. Nga ana tjetër, duke qenë se jemi mësuar të lexojmë libra autobiografikë me struktura të varfra kompozicionale, kronika sterile pa stil, thjesht komplekse të rrafshëta lineare informacionesh e gjeneralitetesh, leximi i këtij libri na vë përballë një niveli të lartë artistik të tekstut, që jo në pak raste shfaq cilësi të një proze poetike të arrirë. Struktura e kombinuar dhe mjaft e studiuar e veprës, me një arkitekturë ciklike, arsenalit stiletmatik, depërtime të thella psikologjike, përshkrimet e gjalla e mbresëlënëse, falë hipotipozave dhe ekfrazës përdorur nga autori, dëshmojnë për eksperiencën të mëparshme dhe vokacione të njëmendëta letrare, që doemos i tejkalojnë hapësirat e zhanrit. Kjo duket edhe nga disa zgjidhje të tjera kompozicionale, siç është mekanizmi i narracionit që vihat në lëvizje nga çastet e udhëtimeve dhe fotografitë e së shkuarës. Një tipar që spikat si veçori mjaft origjinale është edhe ndërputja brenda nyjzave të rrëfimitarish edhe e mjaft parashenjave, që ndjellin ngjarje të rënda; ose fanitje imazhesh të njerëzve të vdekur tragjikisht, në mënyrë surreale dhe tronditëse që kufizon me pasazhe të realizmit magjik. Kemi kështu shfaqjen e motrës së mbytur, Dushës, jo në ëndërr por në zhgëndërr ose dhe parandjenjën e vdekjes së nënës, shfaqur në një ëndërr në trenin e një metroje në Amerikë.

Në vështrimin e përgjithshëm të strukturës kompozicionale libri ndahet në dy pjesë: pjesa e parë hapet me kreun retrospektiv të hyrjes në Amerikë, për të vazhduar me dhjetë kapituj të tjerë, që i kushtohen fëmijërisë, vendlindjes, prindërve, jetës në Malësi me të gjitha variacionet dhe koloritin që e karakterizon. Këtu vlen të citojmë një shënim të autorit

Vështrim mbi librin "Porosia e kullës" të autorit Pashko R. Camaj

## Kthim në vendin e origjinës si kërkim i kuptimit të jetës


Nga Zija Vukaj

neorealist italian Paveze të Zanati i të jetuarit, datë 12 shkurt 1942, ku shkruan: "Arti modern është- në aq sa vlen- një kthim në fëmijëri. Motivi i tij i përjetshëm është zbulimi i gjërave, zbulim që mund të ndodhë, në formën e tij më të pastër, vetëm në kujtimin e fëmijërisë. (...) Dhe në art shprehet mirë vetëm ajo që ishte përthithur në mënyrë të pafajshme. Nuk u mbetet artistëve vetëm të kthehen e të frymëzohen në epokën kur nuk ishin artistë; e kjo është fëmijëria". Këtu çdo kapitull ka një titull, që përbën një fjalë a togjalësh kyç një koncept simbol, një lloj passwordi që jo vetëm davarit hijezimet e labirinteve narrative, por bëhet edhe një *gestalt* që lejon transpozimin e këtyre formave- cilësi në një çelës të ri, duke përdorur hijezime krejtësisht të ndryshme e duke ruajtur ende identitetin e vet.

Në peshën specifike të librit kjo pjesë është me një rëndësi bazike. Këtu autori ka ngulitur, përshkruar, përjetuar e perceptuar ato mitet obsesive, që janë pjesa e përbashkët e gjithë lexuesve të lëtij libri. Në botën e brendshme të autorit-protagonist mbetet i pazhbëshëm imazhi i Kullës. Ky mit i dashur dhe aq hijerëndë në përfytyrimin e banorit të saj fëmijë, është një realitet zanafilor, i ëmbël e gati i frikshëm është fillimbota e ekzistencës dhe arena e dinamikave të përditshmërisë. Ky djep i madh e i paprekshëm është institucion, është shkolla e parë e njeriut shqiptar; është tempulli i besës, i moralit, i mikpritjes dhe i sigurisë. Është memoria e breznive dhe streha e shpirtit të gjithë atyre që kanë lindur e jetuar aty. Është galeria e profileve fisnike të burrave e

grave të një familjeje të dinjitetshme që kanë lindur aty ose i kanë përmblyllur jetët e tyre brenda saj. Në perceptimin e protagonistit kulla jepet e animizuar, gjë që spikat fort edhe në titull "Porosia e kullës". Përshkrimin e strukturës së saj autori Pashko Camaj e ka dhënë mjaft hijshëm. Hijeshia e saj qëndron tek e thjeshta. Një ndërtesë drejtëkëndore, ndërtuar me gurë mali e lëndë pylli, me konstrukt të fortë, pa ndarjet që karakterizojnë banesat moderne. Por aty gjithçka është e tejpashme, e dëlirë, e ngrohtë. Mjedisi i saj ngrohet nga fryma e pastër e banorëve, nga sinerjia e tyre për të përballuar me dinjitet sfidat e vështira të mbijetesës, duke mbetur teatri harmonik i bashkësisë familjare. Prandaj edhe fuqia e saj simbolike është e magjishme, prandaj porosia e saj mbetet testament i breznive.

Duke udhëtuar në faqet e këtij libri krijohet ideja se kjo vepër është "himni i babait". Camaj ia ka dalë të krijojë një profil të rrallë për babën e tij Rrokun. Në përvijimin e këtij portreti bie në sy jo vetëm dashuria e pamatë për këtë personazh, por edhe aftësia për të qëndruar në ekuilibrat e parimit të arsyes. Ky parim realizmi e ka shpëtuar autorin- protagonist pa rënë në ekzaltime subjektive që do ta zbehnin besueshmërinë ndaj heroit të vet. Babai është një burrë i hajthëm, me probleme shëndetësore, i heshtur dhe tepër modest. E megjithatë pas pamjes thuasje të brishtë të Rrokut, kemi shpirtin titanik të një burri të drejtë, të ndershëm, stoik, guximtar dhe altruist si askush tjetër. Kjo dëshmohet nga përballja burrërore e tij me vdekjen, në emër të jetës së bashkëfshatarëve të tij, duke




hyrë mes plumbave që ata i kishin drejtuar njëri-tjetrit, duke shkruar për vete në zgripin e vdekjes e duke u kujdesur heroikisht edhe për pajtimin e tyre. Përfundimisht, babai ishte një burrë me aureolën sublime të një individit model në të gjithë malësinë.

Një vend të rëndësishëm zë në këtë pjesë edhe epifanizimi i shumë gjemave që i ndodhin familjes, por edhe përshkrimi i çasteve të tjera, duke mos harruar ritualet dhe shumë elementë etnokulturorë që përbëjnë sfondin e ndeshtrashave të jetës. Mbresëlënëse mbeten sidomos tri ngjarje: Vrasja gjyshit, me aureolën e një Priami nga forcat komuniste, vdekja e motrës dhe martesë e Lezes. Në rrëfimin dhe përjetimet mbi këto ngjarje, autori ka shpalosur faqet më të bukura të librit. Po kështu një vend qendror në libër i rezervohet përndjekjes nga politika, regjimi, shkaqet etnike, që bëhen faktorë të rëndësishëm për të kërkuar e shpresuar rrugëdalje individuale e kolektive të kësaj popullsie të fisme por të shtypur.

Pjesa e dytë përbëhet nga shtatë kapituj dhe i kushtohen përvojës amerikane të protagonistit- autor. Libri tashmë ka kaluar nga atmosfera distopike e një bote dhe jete thuasje pa rrugëdalje, në dritën e shpresës dhe realizimit të ëndrrave aq të natyrshme dhe të merituar për çdo qenie njerëzore, aq më tepër të një djali plot dhunti, që jeta i kishte dhënë fare pak. Kurba e udhëtimit në jetën dhe botën e re, megjithë vështirësitë, mallin, privacionet, ndjenjën e fajit gati bibliq të largimit, është në ngjitje. Kjo falë hapësirave që të jep mjedisi amerikan si dhe falë vetive të spikatura të një djali me karakter të fortë e qëllime të qarta. Autori-protagonist Pashko Camaj fiton shumëçka në rrugëtimin e tij: fiton një formim akademik dhe pozicione të rëndësishme pune, krijon një familje sipas ëndrrës së tij, respekton dhe respektohet nga të gjithë, duke gjetur kuptimin e vërtetë të jetës. Atë kuptim që e pati marrë si porosi nga Kulla e lashtë. Porosia e kullës ishte që bijtë e saj të bëheshin të njohur për fisnikëri, atdhetari, dije dhe moral, duke u bërë trashëgimtarët e vetive më të larta të gjenit shqiptar.

Dhe si për të përmblyllur konceptimin ciklik të kompozicionit, si dhe logjikën e rrugëtimit të vet thuasje të pazakontë autori Camaj nuk mund t'i shmanget kthimit, i cili bëhet semiotika e prekshme e kuptimit të jetës. Është kthimi te miti i tij obsesiv, te Kulla, tashmë e plakur, por shumë e rëndësishme. Dhe natyrisht ky është takim- homazh, takim me pjesën e fjetur të nënvetëdijes: "Rrezet e diellit vërshuan mbi kullën gri e gjysmë të rrënuar. Muret prej guri që rrethonin halinë ishin pothuajse të shembura. Ishin si një guaskë e thatë. Megjithatë, ishin ende aty, duke u përpjekur të sfidonin kohën. Pyesja veten se çfarë do të më thoshin nëse ato mure të shkatërruara mund të më flisninE gjeta veten duke ngjitur shkallët e vjetruara, që tregonin moshën e tyre dhe neglizhencën që solli koha. Ngadalë, si për të kërkuar falje që shkelja në fytyrat e tyre të gdhendura në gurë dhe duke u munduar të mos shkel në lulet e egra që kishin gjetur jetë mes gurëve shekullorë, i ngjita të katërmbëdhjetë shkallët." Akoma më shumë se nisja, është kthimi miti i vërtetë, ai që në termin grek quhet "nostos", duke nënkuptuar kthimin në vendin e origjinës si mbërritje e çdo qenieje njerëzore në kërkim të vetvetes e të kuptimit të jetës.









Alush Bello është një nga miqtë e Ami të rinisë. Kemi qenë bashkë në universitet. Në përfundim të studimeve, ai u emërua mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në një fshat në rrethina të Vlorës, ndërsa mua më çuan si redaktor letrar në shtëpinë botuese të librit teknik. Pra, në Tiranë. Kështu, në njëfarë mënyre, humbëm nga sytë e njëri-tjetrit, por pa u fshirë nga kujtesa.

Ndryshe nga shumica e studentëve të asaj kohe, të cilët ishin të ngjashëm pothuaj në gjithçka me njëri-tjetrin, Alush Bello kishte diçka të veçantë që binte në sy vetëm tek ata që kalonin kohë me të. Unë isha njëri prej tyre. Ai kishte një pasion të pashpjegueshëm për letërsinë amerikane. Nuk isha vetëm unë që nuk e kuptoja nga i buronte ky pasion, duke pasur parasysh se, ndër të gjitha letërsitë e mëdha të botës, ajo amerikane ishte më pak dhe më keq e njohura te ne. Më saktë, vepra e autorëve amerikanë ishte pothuaj krejt e panjohur për ne. Shqipëria nuk kishte asnjë marrëdhënie politike, diplomatike, ekonomike apo kulturore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e as me Mbretërinë e Bashkuar. Rrjedhimisht, çdo lloj botimi letrar në gjuhën e këtyre vendeve e kishte derën rreptësisht të mbyllur, ani pse anglishtja mësohej në shkollat tona të të gjitha niveleve. E mësonim edhe ne, studentët e fushës së gjuhës e të letërsisë shqipe, dy orë në javë. Dhe ky ishte një paradoks. As nuk na e kishin shpjeguar përse do të na hynte në punë anglishtja në realitetin ku jetonim e do të jetonim deri në ditën e fundit sipas të gjitha parashikimeve dhe as ne nuk e kishim shtruar një pyetje të tillë para vetes dhe as para atyre që kishim mbi kokë.

Përkthimet nga kjo letërsi në shqip përcaktoheshin me rreptësi nga katalogët e botimeve në Bashkimin Sovjetik në vitet '30, kur mbyllja staliniste ndaj "të huajve" ishte më e ashpër se kurrë. Për t'i rënë shkurt, kishim të botuar në gjuhën tonë një përmbledhje me tregime të Mark Tuenit dhe romanin e tij *Një amerikan në oborrin e mbretit Artur*, një antologji të tregimit amerikan të shekullit XIX dhe poezinë *Korbi* të Edgar Alan Poes, me përkthim të Fan Nolit. Ishte edhe një përmbledhje me poezi të zgjedhura nga *Fije bari* i Uollt Uitmanit. Unë të paktën kaq kam gjetur asokohe në bibliotekën e fakultetit, e cila do menduar se ishte nga më të pasurat në vend me librin në shqip. Ishim në dijeni edhe të përkthimit të *Plaku dhe deti* të Heminguejt nga Ismail Kadare, botuar në një ndërkohë fare të shkurtër, me ca shenja të "shkrirjes së akujve" që kaloi edhe Shqipëria në kapërcyellin e shpejtë të viteve '50-'60. Por, kur mbërriti brezi im në moshën për ta lexuar, ky ishte një libër i ndaluar tashmë dhe i hequr nga qarkullimi si i dëmshëm për shijet estetike të brezit të ri.

Ne, si studentë të filologjisë, që përgatiteshim për t'u bërë mësues, ndriçoheshim me dy a tri leksione panoramike të përkthyer nga tekstet e vjetra universitare ruse. Na përmendeshin një mori emra autorësh të dy shekujve të fundit të letërsisë amerikane, shoqëruar me një mori titujsh nga romanet e tyre, të cilët në shumë raste ishin të përshtatur për afërsisht. Gjithsesi, ne ishim të detyruar t'i mësonim përmendsh emrat e autorëve dhe titujt e librave të tyre për t'i recituar në provim, pa e ditur vërtet se për çfarë po flisnim. Lidhur me këta shkrimtarë na takonte të prananim kryesisht sa të verbër kishin qenë ata në pasqyrimin e realitetit të egër kapitalist të vendit të tyre. E keqja



BESNIK MUSTAJ

## Zbulimi i Amerikës nga shqiptarët

Fragment nga novela

e tyre e pashërueshme përmbledhje te fakti se kishin jetuar njëkohësisht me Marks dhe kishin vdekur pa e zbuluar *Manifestin e tij të Partisë Komuniste*, për pasojë pa e mishëruar këtë tekst udhërrëfyes në veprën e tyre letrare, duke krijuar heronjtë pozitivë, siç kishte bërë Gorki në Rusi, me qëllim që proletariati amerikan të edukohet dhe të frymëzohej për t'u ngritur pastaj në revolucion për të vendosur diktaturën e klasës punëtore, duke shpëtuar kështu veten dhe botën nga shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Veçanërisht e pamëshirshme ishte kritika për shkrimtarët e shekullit XX, të cilët nuk kishin dashur të hapnin sytë për të parë te Revolucion i Bolshevikit i Tetorit dhe tek ideologjia leniniste dritën e së vërtetës dhe të shpresës për popullin punonjës. Me një fjalë, në qasjen tonë si studentë nuk kishte asnjë shqyrtim të estetikës së prozës apo të poezisë, që autorët amerikanë kishin shkruar. Të njëjtat përgjigje si ne të tjerët duhej të jepte në provim edhe Alush Bello, pa shtuar asgjë nga vetja. Madje as pa u tunduar për të shtuar diçka nga vetja. Tundimi do të mjaftonte për ta quajtur mëkatit të kryer. Por nuk ndodhte dhe sipas bindjes sonë, nuk kishte mundësi për të ndodhur.

Në këto rrethana, pasioni sa i shpallur e po aq i pashpallur i Alush Bellos për letërsinë amerikane jo vetëm duhej të ngjante i kotë, por edhe kishte njëfarë thelbi – le të themi tani enigmatik, për të mos përdorur me vonësë ndonjë fjalë kundërthënëse. Por, nga ne, shokët e tij të shkollës, falë një ndikimi të mistershëm, të cilin nuk do ta kuptonim kurrë nga kishte ardhur, ky pasion i Alush Bellos nuk shihej atëherë si mish i huaj. Nuk kam dëgjuar kurrë ndokënd të bënte as atë pyetjen sinqerisht asnjë: Ore, si mund të duash, madje me kaq zjarr, diçka që nuk e njeh? Nuk e di sa të thelluara ishin asokohe njohuritë e Alush Bellos në lëndën e gjuhës angleze, por gjatë dy orëve javore të mësimit të kësaj lënde ai dukej

gjithsesi më i përparuar se ne. Megjithatë, ai jetonte në konvikt, në Qytetin Studenti, njësoj si secili prej nesh, në një dhomë me tri krevate dykatëshe, ose "krevate marinari", siç quheshin, ku strehoheshin gjashtë studentë. Kjo hollësi ka vlerë për të përfytyruar tani se ai nuk kishte, në fakt, asnjë mundësi të mbante në dorë për të lexuar diçka jashtë vëzhgimit të të tjerëve. Unë isha njëri nga të pestët që banonin prapa së njëjtës derë me Alush Bellon. Dhe mund të dëshmoj se ai nuk ishte parë kurrë, ditën as natën, të mbante në dorë librin e ndonjë autori amerikan në botimin original.

Vetëm një herë na dha rast të lëkundeshim në bindjen tonë se, në fakt, as ai nuk dinte më shumë se ne lidhur me letërsinë amerikane. Në njërin nga paraqitjet panoramike mbi këtë letërsi, profesori i kishte kushtuar një paragraf Uiliam Folknerit, duke përmendur edhe kontenë Jokna-patofa. Në leksionet e shtypura dhe të shumëfishuara me shaptilograf, që na shpërndante profesori, emri i kësaj konteje apokrifë shkruhej sipas parimit fonetik që përdor gjuha shqipe. Por, Alush Bello, në dhomë, një pasdite, na tregoi se dinte edhe ortografinë origjinale: Yoknapatawpha. Ku e kishte mësuar? u ngritën tre a katër zëra të mahnitur. Midis tyre edhe zëri im. Do të kisha thënë se, më shumë se kureshtje, zërat tanë shprehnin njëfarë zilie të pavetë-dijshme. Pasi një dyshim: me gjithë ato germa të ndërlikuara, ky emër nuk na u duk si anglisht. Të paktën jo si anglishtja që mësonim ne. Mos e kishte sajuar ai për të na bërë përshtypje? Për t'u shmangur përgjigjes, por jo si dikush që ruan një të fshehtë, ai hodhi një pyetje që na hutoi fare: Po sikur edhe vendlindja e Folknerit të ishte apokrifë: New Albany? Me një përkthim pak të lirë, ajo jepte: Shqipëria e Re. Për më tepër, i binte që Folkneri të kishte lindur në atë Shqipërinë e Re amerikane më shumë se gjysmë shekulli para se Shqipëria jonë të bëhej e Re.

Lidhur me rastin e Alush Bellos, fatmirësisht, gjatë katër viteve që studiuam së bashku, syçeltësia revolucionare e ndonjërit prej nesh nuk shkoi kurrë në atë drejtimin e akrepave të orës zyrtare. Studentët ishin në përgjithësi bij entuziastë politikë të kohës, kur kishin lindur dhe po rriteshin, duke u pjekur nën të njëjtin diell ideologjik, pa zgjedhje të dytë apo të tretë. Do të duhej të ishte krejt e pritshme që pyetja të shtrohej haptas, pa asnjësi dhe do të dilte me shumë spec: Ore, si mund ta duash, madje me zjarr, një letërsi e cila dashje pa dashje i ka shërbyer dhe vazhdon t'i shërbejë klasës më të egër kapitaliste të botës për të përjetësuar shfrytëzimin e njeriut nga njeriu?

Mjaftonte që një pyetje si kjo të mbinte në kokën e një studenti të vetëm për të çelur një telash me pasoja zinxhir, shumë të rrezikshme për Alush Bellon. Në vazhdim pyetjet do të bëheshin tërëzime për t'u lidhur rreth qafës së tij të hollë e të gjatë. Por me rrezik të madh do të kishte qenë një pyetje e tillë edhe për ne, shokët e tij të dhomës, që e kishim dëgjuar pa i treguar vendin atij shejtan-budallait. Përgjigja e parë, e menjëhershme dhe më e zakonshme nga ana jonë, do të duhej të ishte: Kush tha se ne nuk e njohim Amerikën imperialiste, xhandaren e popujve të shtypur, keqbërësen më të madhe të njerëzimit të sotëm? Do të ishte një përgjigje pa lidhje me letërsinë amerikane dhe as me letërsinë në përgjithësi. Por, do të ishte një përgjigje e shprehur si pyetje, për t'u lënë vend nënkuptimeve të përcaktuara, të gjitha si pasqyrim i brumosjes sonë në përputhje me kallëpin e njeriut të ri. Rrjedhimisht, një pyetje e tillë retorike nga ana e ndonjërit prej nesh do të çonte te një pyetje e dytë, kësaj here fare konkrete: Çfarë fsheh Alush Bello pas kësaj të ashtuquajturë dashuri për shkrimtarët amerikanë? Ose edhe më konkretisht: A fshihet armiku i jashtëm pas dashurisë së shtirur të Alush Bellos për veprën e shkrimtarëve amerikanë? Përkthimi i saktë i kësaj pyetjeje do të ishte: A është Alush Bello spiun i amerikanëve? Është e lehtë sot të përfytyrohet si do të kishte qenë vazhdimi: një tragjedi. Por nuk ndodhi. Madje ne, shokët e tij të studimeve, nuk e përfuam kurrë as si enigmë pasionin e tij për një letërsi të cilën ai, ashtu si ne, në të vërtetë, nuk e njohje. Megjithatë, mbetet fakt se pasioni i tij për letërsinë amerikane ngjallte ndër ne njëfarë trazimi të papërcaktueshëm, pa asnjë ngjashmëri me trazimet e tjera të thjeshtëzuara të moshës.

\*\*\*

"Enigmë" ishte, pra, përcaktimi që më erdhi menjëherë ndër mend lidhur me këtë histori dyzet e një vjet më vonë, kur e hasa Alush Bellon krejt papritur, një fund pasditeje shtatori, në Times Square. Pata sakaq përshtypjen se kisha gjetur fjalën e duhur. "Enigmë", përsërita. Ky është frymë-zimi, thashë, jo dhe aq për të qeshur pak me veten. Po për çfarë frymëzimi ishte fjala? Gjendesh në Nju-Jork prej disa ditësh për të marrë pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së. Në seancën e asaj pasditeje e kishin radhën për të folur ministrat e jashtëm të disa vendeve afrikane, të cilët nuk pritej të shtronin probleme që do të prekjin posaçërisht politikën e jashtme të Shqipërisë. Sidoqoftë, në sallë do të ishin gjithë kohën ambasadori dhe drejtori im i kabinetit bashkë me diplomatë të tjerë,

të cilët do të mbanin shënime për të më vënë pa vonesë në dijeni në rast nevojë. Telefonin e dorës do e kisha gjithsesi me vete.

E kisha zgjedhur atë pasdite si më të lirën për t'i plotësuar vetes një dëshirë të vogël pa lidhje me detyrimet e mia si ministër. Do të dilja shëtitje. Do të sorollatesha disa orë krejt vetëm, dembelisht, i shpërqendruar, me trurin pasiv si një sfungjer, nga të më çonin këmbët nëpër Manhattan, siç më pëlqente të bëja gjatë viteve të fundit sa herë mundesha nëpër qytetet e mëdha të botës, ku isha kalimtar, por jo si turist. Dhe të tilla ishin zakonisht udhëtimet e mia nëpër botë: për punë. Vetëm një herë në jetën time e kam marrë avionin bashkë me gruan si turist. Për t'iu shmangur ndonjë shoqërimi të bezdisshëm për mënyrën si e bëja unë shëtitjen time, bashkëpunëtorëve u thashë se do të qëndroja në dhomë për të punuar. Ishte si një urdhër për të mos i rënë telefonit tim pa një arsye të fortë. Isha në hotel "Waldorf Astoria", në Park Avenue.

Kisha përcaktuar paraprakisht vetëm njëfarë drejtimi: Do të shkoja në "31, Chambers St." për të parë nga jashtë "Surrogate's Court". Më kishte rënë në sy ky emër të mbrëmshmen duke parë pa ndonjë përqendrim një hartë turistike të NY, nga ato harta që shërbehen falas në hollin e hotelit dhe më kishte bërë menjëherë përshtypje, duke më ngjallur një nga ato kureshtjet pa kuptim, por argëtuese për mua. Nuk kisha bërë në vazhdim asnjë kërkim për të kuptuar se çfarë ishte në të vërtetë kjo lloj gjykate e surrogatëve. Sipas një ushtrimi mendor instinktiv, i cili zakonisht më shërbente për ta zbrazur kokën nga hallet e punës, në përfytyrimin tim ishte përkthyer vetëm "court", ndërsa për "surrogate" kisha transferuar mekanikisht kuptimet vetëm përcmuese që kjo fjalë me zanafillë latine kishte marrë nuk e di qysh kur, duke hyrë në shqip, ku përdorej edhe si emër edhe si mbiemër për të përcaktuar qoftë figurativisht e qoftë konkretisht një njeri shtinjak, por edhe një send të rrejshëm, pa ndonjë vlerë të vetën. Si mund të ishte një gjykatë, që jepte vendime lidhur me njerëzit apo sendet, e rrejshme? Kush paraqiste ankesë para një gjykate si kjo? Si zgjidheshin gjyqtarët? Cila ishte detyra e prokurorëve në një proces të tillë? Po detyra e avokatëve? E kisha sakaq atë thesin e kotësive të mendjes plot me pyetje kryekëput të përçartura. Domethënë: kisha gjithë çfarë më duhej për t'u kënaqur gjatë shëtitjes nëpër Manhattan.

Kam ardhur shumë herë në Nju-Jork gjatë periudhës së fundit, duke qëndruar në çdo udhëtim disa ditë dhe gjithmonë në Manhattan. Kam kaluar, kështu, në çdo rast, ca orë dite ose nate duke ecur vetëm, në këmbë, sipas mënyrës sime, rrugëve të tij. Rrjedhimisht, këtë vend e njoh thelathela, siç mund të njihet një mozaik i thyer e me copat të shpërndara halladan. Po shkoja kësaj here pa ndonjë nxitim drejt rrugës "Chambers", ku e dija se nuk do të gjeja përgjigje për pyetjet që më lëvrinin në kokë si peshq dekorativë. Madje as nuk do t'i kërkoja këto përgjigje në "31, Chambers St." dhe as ndokund tjetër. Nuk kisha ndonjë nevojë për të kuptuar. Përkundrazi. Një sqarim i përmbajtjes së "Surrogate's court" do t'ia hiqte përfytyrimin tim arsyen për të vazhduar lojën, ku tashmë kishte hyrë edhe fjala shqipe "surat", e cila nuk më ngjante si huazim me prejardhje latine, por që në shqiptim më lidhej ngushtë me "surrogate". Po më dukej se ngjashmëria

nuk ishte vetëm në shqiptim, domethënë së jashtëmi, e që mund të ishte lehtësisht një coincidençë rastësore fonetike. Përdoret në disa të folme krahinore edhe si sinonim për "dordolec", përdoret edhe për të treguar dukjen e dikujt ditën e karnavaleve. Po shkoja, pra, për të parë si dukej selia e "Surrogate's Court", duke mbajtur gjithnjë parasysh vetëm përkthimin në shqip të fjalës "court". Dhe pyesja veten gjithë seriozitet si do të ishte një gjykatë për surretërit, ku përfshiheshin shtiekëqijtë, dordolecët, palaçot e karnavaleve dhe shumë të ngjashëm me ta. Me të njëjtin seriozitet shkova edhe më tej: Me mbështetjen e qeverisë amerikane, Shqipëria do të ndërmerre së shpejti një reformë të thellë të sistemit të drejtësisë. Me t'u kthyer në Tiranë, do të kërkoja të parashikohej edhe ngritja e gjykatës për surretërit. Pse jo? Papritur, nga errësira mjegullorë e kujtesës doli një varg i García Lorca-s dhe iu bashkëngjit këtyre përfytyrimeve të shthurura. "Maska e zezë! Shihni maskën e zezë!" Është si një refren te poezia *Vallja e vdekjes* në përmbledhjen e tij *Poeti në Nju-Jork*. Hapa sytë rreth e rrotull në kërkim të maskës së zezë. Ajo mund të ishte e padukshme për të tjerët. Por jo për vështrimin tim, i cili buronte sakaq nga sytë e poetit García Lorca.

Aty për aty nuk po më kujtoheshin vargje të tjera nga kjo poezi, lexuar fshehurazi dhe madje përkthyer në shqip kur isha ende student. Por mjaft që më kujtohej titulli (*Vallja e vdekjes*), i cili i shkante për bukuri turbullirës që kishte pushtuar sakaq përfytyrimin tim atij pragmuzgu vjeshtor në Manhattan, duke u çapitur si i përhënuar në drejtim të

"Chambers St.". Kujt do t'i përshtatej më mirë maska e zezë, surretëve të akuzuar apo gjyqtarëve të tyre? Apo secila nga palët kishte maskën e vet të zezë si pjesë të uniformës së dallueshme? Qoftë edhe për të shtruar një pyetje të tillë absurde, ia vlente mundimi që kisha hequr dikur me këtë poezi, të cilën edhe unë ashtu si ai që ma kishte huazuar e kishim kopjuar me dorë pikërisht pse nuk kishim asnjë shpresë për ta mbërritur ditën kur një letërsi të tillë mund ta gjenim lirisht në libraritë apo në bibliotekat publike të Tiranës. Kopjimi me dorë i kryeprave të letërsisë së huaj, njohja e të cilave na ishte ndaluar, mbetet një ushtrim plot domethënie, që shkon përtej shprehjes së dëshpërimit, për të mishëruar në fakt realitetin e mungesës së ëndrrës për çlirim, ku po brumoseshim ne, shqiptarët e rinj. Poezia e García Lorca-s ishte rreptësisht e ndaluar për lexuesin shqiptar, edhe pse pushkatimi i tij përmendej gjerësisht nga propaganda si një nga krimet shembullore të diktatorit Franco kundër revolucionarëve republikanë. Për të mirën time, nuk duhej ta dija si i kishte rënë në dorë ky tekst shokut tim. Dhe nuk do ta mësoja kurrë. Mjaft që ai kishte pasur shtyrsën për ta kopjuar në një fletore, duke marrë në sy rrezikun për t'u dënuar me disa vjet burg po të kapej nga Sigurimi. Të njëjtin rrezik mora edhe unë, që e kopjova gjithashtu dhe kalova shumë orë me të. As shoku im dhe as unë nuk dinim spanjisht.

Në të vërtetë, asokohe unë nuk njihja askënd që të dinte spanjisht. Në rastin më të butë do thënë se spanjishtja, ashtu si shumë gjuhë të tjera të kulturës së madhe të njerëzimit, vlerësohej nga regjimi si e

panevojshtme për edukimin e njeriut të ri shqiptar. Unë e kisha tashmë krimbin për ta lexuar me patjetër poezinë në fjalë. Në mungesë të një fjalori spanjisht-shqip, i cili thjesht nuk ekzistonte në leksikografinë shqiptare, arrita të gjej një fjalor spanjisht-rusisht. Pastaj një tjetër rusisht-shqip. I ndihmuar edhe nga frëngjishtja dhe italishtja, që zotëroja tashmë, ia dola në njëfarë mënyre të merrja një përshtypje sado të përafërt mbi stilin poetik të Lorca-s. Duke u afruar hap pas hapi drejt "Surrogate's Court", po më pëlqente të besoja se rruga fort e spërdredhur që kisha ndjekur dikur për të hyrë në brendësi të kësaj poezie, duke kaluar përmes një fjalori rusisht, të botuar në Moskë në kohën sovjetike të Stalinit, ngërthente njëfarë simbolike, e cila doemos pasqyrohej në turbullirën e përfytyrimit tim gjatë shëtitjes për te "Gjykata e surretëve" në "31, Chambers St.". Pikërisht ky lloj pasqyrimi filloi të më shpërndante në kujtesë një si dritë qiellore, duke e bërë pak nga pak të dukshëm edhe fundin e poezisë *Vallja e vdekjes*: "Maska e zezë/ Shikoni maskën e zezë/ si pështyn një helm pylli/ mbi ankthin e pakryer të Nju-Jorkut!"

\*\*\*

Po shkoja drejt "Chambers St." duke u çapitur krejt kuturu. Herë pas here sillja nëpër mend si hije atë hartën skematike të qytetit, ku kisha hedhur një vështrim të shpejtë e të shkujdesur para se të dilja nga dhoma e hotelit. Me aq sigurisht që nuk do të isha në gjendje të ngulisja në kujtesë një itinerar në një qytet të madh e të huaj si Manhattan. Po i hidhja hapat si njeriu që shkon diku ku nuk e presin dhe i cili nuk ka asnjë orar për mbërritje. Madje, nuk do të më prishej qejfi edhe sikur të mos mbërrija kurrë në "31, Chambers St.", ashtu siç Kolombi nuk u mërzi pse nuk mbërriti kurrë në Indinë e vërtetë. Fantazimet rreth "gjykatës së surrogatëve" m'i kishte ndërprerë sakaq maska e zezë e García Lorca-s, e cila vazhdonte të pështynte një helm pylli mbi ankthin e pakryer të Nju-Jorkut. Vëmendja ime u mbërtheve sakaq te cilësori "i pakryer", me të cilin Lorca përcaktonte ankthin e Nju-Jorkut. Vura re se në shqip mund të përkthehej edhe si "i papërfunduar", por edhe si "i papërsosur". Cilin nga këto kuptime kishte pasur parasysh poeti? Vendosa që, me t'u kthyer në hotel, nëse nuk do të kisha ndonjë përfshirje të paparashikuar në punët e zyrës, do të kërkoja në internet për të gjetur si ishte përkthyer kjo fjalë në frëngjisht, në anglisht e në italisht. Ankthi i Nju-Jorkut vazhdonte të ishte aty, pllakosës, pushtues. Por, arsyet e lindjes së tij doemos që nuk ishin më ato që kishin qenë në kohën kur Lorca shkruante këtë poezi. Ai kishte jetuar në Nju-Jork në periudhën më të keqe, atë të depresionit të madh. Tani, nisur pikërisht nga Bursa, mund të flitej për periudhën e lulëzimit të madh. Megjithatë, ky lulëzim i madh jetohej nga qyteti pa ndonjë ndikim çlirues nga ankthi. Kisha lexuar diku se Nju-Jorku është qyteti me përhapjen më të madhe në botë të kabinetëve të psikanalistëve. Tashmë mund të bëhej një përkthim i ri i këtij vargu të Lorca-s, duke e përshtatur vetëm cilësorin në fjalë (*imperfecta*) me zanafillën e ankthit modern të këtij qyteti, damkës së të cilit nuk po i shpëtoja dot as unë, edhe pse krejt kalimthi këtu dhe pa asnjë mëtim për të hyrë në jetën e tij të brendshme, atë shpirtërore.



## RRUGËTARI

Sa shumë kam ecur! Si amfora  
qafëgjata  
eshtrat i kam të mbushura me lodhje  
Ulem te një bordurë, nën drurë tek  
po bie nata  
si një detektiv që e fsheh  
vendndodhjen

Vë re në qiell lart një re – është një  
anije  
me një ngarkesë yjesh në bord  
që m'pikojnë në t'gjelbrën e errët të  
degëve mbi krye  
ndërsa kam një etje që nuk e shuaj dot

Qytet milionësh. Makinat që vijnë dhe  
shkojnë  
bëjnë zhurmë. Zë njeriu nuk dëgjohet  
Dhe po ato makina shkulme dritash  
lëshojnë  
por hijet nuk ndriçohen

Në disa gjëra dyshoj, në shumë nuk  
kam besim  
Ndonjë gjë që m'ik kënaqësi më jep  
Ndonjë gjë që më vjen, më jep  
drithërimë  
si një avion që shkon ulët mbi qytet

Po të më pyesë dikush, nuk di kah kam  
qenë  
por di se dikend kam ndjekur në çdo  
hap  
ia kam ndier frymëmarrjen dhe rrahjet  
e zemrës  
dhe e kam humbur, dhe m'është  
shfaqur prapë

tek flet me dritën, jo-dritën dhe të  
bukrën  
pa hequr dorë prorë dhe pa u ngutur  
si një zog që njësoj e fal këngën e vet  
te kupola e kishës dhe te tarraca e  
burgut

Dhe i kam dëgjuar të fshehta që vijnë  
jo t'paditura  
por pa e ditë si shfaqen – tokë çudirash  
që befash del mbi ujë, dhe po n'ujë  
pasqyrohet  
nën dritë ylberesh, ndërsa një mjegull  
largohet -

Shtëpinë e kam ngrit' mes kopshtesh  
të jetës  
me ballkonin kah nata dhe me portën  
kah dita  
ku rrinë pranë e pranë zemra dhe  
vjersha  
siç rrinë mbi tryezë domatet dhe thika

Pse tjetri m'ik një çast, do e gjej dhe do  
e arrij!...  
Sa e gjallë m'që dita, por tash ajri u  
ftoh  
Me ndenjë në t'fothtë nuk rrihet, me  
ecë duhet fuqi...  
Ti, o qiell i mbrëmjes, më jep të pi një  
gotë!

25 janar 2022

FISHEKZJARRET NDIZEN NË  
MESNATË

Fishekzjarret ndizen në mesnatë  
-pasion dhe bukuri  
zjarr dhe akull  
me një thirrje të qartë  
për dashuri



## SOKOL ZEKAJ

## Koha e qytetit

poezi

për një ngritje shpirtnore  
dhe me një rrezik të fshehur  
që djeg  
që hap plagë-  
kur rrugët janë të zbrazëta,  
qyteti është i qetë...  
Atëherë njerëzit që flenë  
kthehen në krahun tjetër

dhe u hapin një dritare për t'u hyrë në  
ëndrra  
sensuale dhe argëtuese  
me çdo rrezik të harruar  
por me pasionin vezullues  
të larme në ngjyra  
elegante në formë  
vallëzuese në tinguj



të paparashikuara në imagjinatë  
me fjalë tingëluese që bien  
në dritën e tjetrës që vjen  
për t'u rringritur si një zinxhir ari  
në të zgjuar  
kur dita agon  
dhe për me marrë një tjetër formë  
në një tjetër shpirt  
të gatshëm për të rrezikuar  
për t'u ngritur  
në krahët e një ëndrre  
ku plot rastësi na ndihmojnë  
dhe po kaq na pengojnë  
për me gjetë pupla dhe dyll...  
Edhe kur s'i kishim, gjithmonë  
në një natë me yje  
o në një natë me shi  
o në një natë me borë  
në mesnatë janë ndezur fishekzjarre

## KOHA E QYTETIT

Dal në rrugë me të gjitha fuqitë të  
zgjuara  
por hapat s'më binden, ndërrohen  
ngadalë  
ndërkohë që bri meje kalojnë si era  
mosha e re me këmbët që u fluturojnë

2024

## VERA

Ja ku erdhi i nxehti afrikan  
miku që nuk harron  
se unë sot, në këtë moshë prej baobabi  
me përvoja zjarresh e stuhishë  
mes tokës dhe qiellit  
kështu e kujtoj që nga fëminia-  
varë në qafë tamburin me shumë  
ngjyra  
por të gjitha të çelta  
tek e rreh me shkopinj  
rrezesh të zjarrta dielli-  
Më pas vinte nata dhe ai qetësohej  
përpak  
i shtrirë buzë liqeneve a lumenjve  
me fytyrën kah qielli me yje  
me hanën ndër dhambë si një  
buzëqeshje  
e artë dhe ironike  
Tash unë jam një tjetër: sytë e mi  
shohin më pak  
Por teksa përfytyroj  
vendin e tij, Afrikën e Veriut  
me shkretinat e pamata  
e historinë e saj,  
e Salambonë e Floberit  
e arie e simfoni e muzikë lloj-lloj  
në qetësinë e kësaj dite  
që jep e merr me heshtjen  
mbi një libër të hapur  
aventurash jete  
dhe në vetminë time andrruese  
te kjo dhomë e vogël si kabinë  
fluturimesh  
mbi fishkëllimën e lehtë  
të ventilatorit që rrotullohet  
befas sikur ndiej një muzikë!  
një sekuencë muzikore  
të shkurtër- tinguj të qartë e të vërtetë  
si ari i dalë nga rana  
nga një melodi e largët dhe e vjetër  
por jo e panjohur,  
një sekuencë që më përsëritet  
pambarim  
në besim dhe harmoni  
nga Kartagjena e Rrënueme.

27 qershor 2021





## KUMTE

Dimri pas dimrit vjen e shkon e vjen  
nga lodrat pa fund të kozmosit pa mister,  
por rrahim e rrahim në kurdhën e mendimit  
me zjarr eksperimenti.  
Cila është e vërteta? Teoria e energjisë së zezë,  
ajo e multiversit apo ajo e fijeve?...  
Të qarat e foshnjave të porsalindura  
na kumtojnë të vërtetat e së nesërme...

## URIA

Të gjithë duan të hanë,  
nga krimbat deri të njerëzit.  
Kur nuk kanë ç'të përtypin,  
hanë njëri-tjetrin.

## NJË KUJTIM

Po kaloja si mik i ardhshëm përmes rrjeshtave të  
varrezave.  
Qëndrova para pllakës së Besim Turdiut. "Profesor, - i  
thash -  
ti e dije që nuk doja të merrja më shumë se minus tre sa  
për të kaluar.  
Pse këmbëngulje e më qortoje të gëlltisja shifra që më  
dukeshin  
si shkopinjtë të thyer, si vezë të prishura, si degë të thara  
drize?"  
Zëri i ngrohtë i profesorit u valëzua nga pllaka e varrit:  
"Më fal,  
ende atëherë nuk ishte shpikur kalkulatori."

## JETË

Nëna përziente gjellën me lugën e drunjtë  
mbi furnelën me vajguri, të bëhej sa më e shijshme  
me dashurinë e saj për fëmijët përherë të uritur,  
për burrin e tharë përherë të pangopur.

Nëna ngopej me avullin e gjellës,  
me krodhat e bukës.

Fëmijët u rritën si lisa e shkurre...  
Babai u harrua atje në varreza,  
nëna e vetmuar atje në azil  
bisedon me vdekjen.

## PËRSIATJE NË GJUMË

Kur ti bën plane, Zoti qesh me ty.  
Kur do Zoti edhe plumbin  
e shmang nga koka  
te llapa e sipërme e veshit.  
Edhe po të dojë Zoti  
gjarpërinjtë nuk e kafshojnë dot  
Diellin.

## RRËNJËT

Thonjtë rriten (dhe pas vdekjes rriten)  
dhe nuk e dinë se njeriu ka ndryshuar.  
Ai nuk të mbyl më me thonj, ai të shfaros me atom.

Njeriu ende vret njerinë,  
ende egërsinë e ka të fshehur  
jo nën lëkurën e butë, jo nën kokat tullace.  
Me ADN-ën e shimpazes gati puqet.

Thonjtë rriten, ne i presim, ata rriten...

## KUR

Kur je i uritur buka e thatë të duket e ngrohtë  
(qoftë dhe me ca pikëla myku që mund t'i fshish).  
Kur je i etur me diellin mbi kokë,  
dhalla e thartuar të duket si ujët e gurrës  
që gulfon nga rrëza e malit.  
Kur befaz dimri të ngrinë me cigmën dhe erën e egër,



## SAZAN GOLIKU

## Këngë pleqërore ose vargje të ngrira

Poezi

një pallto e vjetër të mbanë ngrohtë.  
Kur të braktisë dashuria mbete tërsisht i zbrazët  
dhe nuk ka lumë që e mbushë qenien tënde.

Statuja u shëmb, u zhduk nga dora e urrejtjes dhe koha.

Po ta shihje sot atë ulkonjë mitike një turist i thjeshtë  
italian  
do të habitej si unë dikur: Ç'do këtu buzë Vjosës  
kjo ulkonjë në këtë vend të huaj?!  
Ai do të qeshte hidhur me lavdinë vrastare,  
me mburrjen qesharake të kryefashistit Duçe.

## VULLNETI

Ing. AM-së

Ti ishe ende vogëlush kur kapërceve Drinosin e kulluar  
pa e kthyer kokën pas.  
U fute në shtigjet e errëta të fatit  
si një dre që brirët u rriten në ndeshje.  
Fluturoje çdo ag me një biçikletë rrak-zhdrak të para  
Luftës  
mes erës së tërbuar, mes shiut të rrebeshtë,  
mes cigmës hidhërake që të priste si brisk fytyrën  
njomzake,  
por ti e pështyje me saçmat e akullta.  
Dielli të digjte dhe dielli të thante kroin e djersës dhe ti  
majë biçikletës e përshëndetje si mik.  
Dërrasa e zezë e klasës të priste e habitur  
me buzëqeshje të bardhë.

Ti fluturoje drejt së ardhmes së panjohur si alpinisti pa  
litar  
që ngjitet guximshëm në shkëmbin e thiktë të sedrës.

E ç'ishin shkallët e mermerta të fakultetit  
para zhgarrëzimave, rrëpirave e honeve  
ku ruaje dhitë e fshatit për të blerë  
një palë këpucë me lëkurë derri dhe librat e shkollës.  
Ti i haje me dhëmbët e mprehtë të ambicies  
bangat e auditorëve dhe qelqet e laboratorëve.  
Bashkëstudentët të donin, por jo të gjithë të kuptonin.

Dhe hape krahët, përveshë mëngët  
dhe gurët e rëndë i ktheje në metal.

Dhe hape krahët... fluturove...  
Vëzhgove lindjen e Diellit në çdo kontinent.

Nga zemra e malit Golik buron Gurra,  
në zemrën tënde ende Gurra rrjedh.

24.6.2024

## KUJTESË LUFTE

Kur isha i vogël, lart nga fshati P. vëreja poshtë tej Vjosës  
diçka të habitshme: Një statujë metalike,  
një ulkonjë që ushqente dy fëmijë!  
Nuk e dija, ajo ishte simbol  
i regjimentit italian "Toskana".  
Ç'donte aty ajo ulkonjë romake  
si qen roje i ushtarëve fatkeq?

## PIKËPYETJE

Pse Sizifi përpiket të ngrejë gurin lart?  
Përse guri rrukulliset poshtë përsëri  
e përsëri në honin e mitit?  
Ende filozofët me pendat e mprehta  
gërrmojnë dheun e ngjeshur të pse-ve.

## PËRMASAT E KOHËS

Ismail Kadarese

1  
Nëpër labirintet mitike  
thellë minierës pa krye të historisë  
gërmon e nxjerr diellin e vjetër.  
Me dritë të re e vesh e ngjesh  
gjakun e sotëm i injekton në deje.

2  
Vëren e gjarpëron me syzet mikroskop  
nëpër ditët akrobatike që përjetojmë hithtas  
e thur e çthur magjinë e artit të tij.

Hedh një hap të beftë në ardhëri  
me rrezit prej andej të sotmen -  
shpërthim fishekzjarresh të fantazisë  
ngrijnë e mbeten brilante shumëngjyrshë.


Flatron vertikalisht nën qiell Europe  
e grindet e gërricet e bën biznes me veten.  
Me kthetra shqiponje - kapur pas rrënjve të thella  
e trungut të çarë të Kombit.

3  
Me syzet teleskop  
cep më cep i bie qiellit të nesërm të copëtuar  
mbushur re të jonizuara të telekomanduara  
re të zeza radioaktive.  
Dhe befaz përlozet për një lulekuqe petalerënë diku...

1972

(Nga libri "Epidemi kozmike")





Karikaturë nga Arben Mexsi

Kambanën e Qelqtë e kam lexuar për herë të parë në klasë të tetë pasi e zgjodha rastësisht nga biblioteka e sime motre. Më tërhoqi kopertina ngjyrë blu e thellë dhe shkrimet nëpër të. Shkruante lart emrin e Sylvia Plath-it, një emër që më tingëlloi kaq i njohur, aq sa kur bëra kërkimin në *Google*, u kujtova se i njihja poezinë "Metaforat" dhe se fill pas shkrimit të kësaj kish kryer dhe vetëvrasjen. Parathënia e librit më tërhoqi me thjeshtësinë dhe njëkohësisht kompleksitetin e shprehjes. Mandej shfletova faqen e parë dhe aty humba në fjalët e saj.

Sylvia Plath vdiq në 11 shkurt të vitit 1963. Ndonëse si poete karakterizohet prej vdekjes së saj, njohja e jetës së Plath-it, se si ishte ajo përtej vdekjes, është mënyra e duhur për të nderuar trashëgiminë e saj letrare. Plath ishte një shkrimtare moderne, që e shpërfaqti botën e vet të brendshme në letër, duke prodhuar kësaj një letërsi që përbashkonte jetën me vdekjen, forcën dhe balancën, duke thyer kufijtë tradicionalë të poezisë për të sjellë në vëmendje dinamikat e lëkundjeve shoqërore të kohës.

Plath lindi në Massachusetts dhe talentin për letërsinë e zbuloi në moshë të re. Poezitë e para i botoi në moshën tetë vjeçare dhe u bë mandej pjesë e konkurseve të ndryshme letrare. Ajo shkroi atë që njihet si *poezia rrëfimore*, që i reflektonte identitetin e saj të thërrmuar. U diplomua në Universitetin e Cambridge-it, ku njohu Ted Hughes, bashkëshortin e saj të ardhshëm.

Gjatë viteve të para diplomimit, Plath përjetonte simptoma të forta të depresionit. Në ditarin e saj shkruante: *"Më duket sikur jeta ime karikohet prej dy telave të korrentit: një të gëzueshëm dhe një jo. Jetën ma dominon më i forti; ai ma mbush jetën."*

Kaloi në mbidozë ngapilulat e marra, u shërua shpejt dhe ndoqi si trajtim psikiatrik goditjet e elektroshokut në institutet e kohës mbi shëndetin mendor. Gjatë shekullit të kaluar trajtime të tilla konsideroheshin ende si stigmatizuese, gjë që e pengonte Sylvia-n të merrte kurën dhe kujdesin e duhur. Gjendja e depresionit i ndikoi dukshëm në shkrimet dhe poezitë e saj, si reflektime të vuajtjeve të veta.

Plath publikoi përmbledhjen e saj të parë me poezi, *"Colossus"*, në vitin 1960, duke u prituri ngrohtë nga kritika e kohës. Gjatë saj periudhe, ajo njihej në rrethet letrare, por jo për lexuesin e gjerë. Megjithatë nga ana tjetër, në jetën e saj private, martesja e Plath po shkatërrohej, dhe në vitin 1962, Hughes ish' dashuruar me një grua tjetër dhe e kishte braktisur shkrimtaren. Në vitin 2017 u zbulua gjithashtu, përmes disa letrave konfidenciale, se Hughes kishte abuzuar me Plath si emocionalisht, ashtu edhe fizikisht.

Gjatë viteve të fundit të jetës, Plath u përfshi në një gjendje tejet të trazuar, e cila u reflektua dukshëm edhe në shkrimet e saj. Ajo botoi romanin e saj të vetëm, *"The Bell Jar"* (Kambana e Qelqtë), një muaj para se të vdiste. Romani përshkruan një vajzë të re, përvojat e pakënaqshme të së cilës e shtyjnë drejt një depresioni të thellë. Edhe pse u botua nën pseudonimin e *Victoria Lucas*, Kambana e Qelqtë

## Jeta dhe vepra letrare e poetes së vlerësuar pas vdekjes.

# NË NDER TË SYLVIA PLATH

Nga Melody Cui

përktheu Jola Tasellari

*"Kurrë s'mund t'i lexoj të gjithë librat që dua; të jem si të gjithë njerëzit që dua të jem dhe të jetoj të gjithë jetët që dua të jetoj. S'mund t'i mësoj dot kurrë të gjitha gjërat që dua të di. E pse dua? Dua të jetoj dhe të ndiej të gjitha ngjyrat, nuancat dhe llojet e eksperiencave nga më të ndryshmet fizike dhe shpirtërore. Dhe jam tmerrësisht e kufizuar..."* – Sylvia Plath

është një pasqyrim i përvojave të Plath-it, një rrëfim fiksional, por po aq edhe biografik, që na zbulon më tepër mbi konfliktet e brendshme që ajo përjetonte.

Romani hodhi dritë mbi rëndësinë e sëmundjeve mendore dhe stigmën që i shoqëronte ato. Imazhet tronditëse të spitaleve psikiatrike pasqyrojnë tmerrin që ajo ndjeu ndërsa kalonte aty kohë të tëra, duke dëshmuar hapur institucionet e dështuara, që ajo dhe shumë të tjerë provuan. Sinqeriteti dhe gatishmëria e saj për të përshkruar seriozitetin e sëmundjeve mendore e vendosën atë jashtë kornizave të autorëve tradicionalë, duke marrë

vëmendjen dhe vlerësimet e kritikëve të shumtë.

Kur Plath kreu vetëvrasjen ishte tridhjetë vjeç dhe la pas dy fëmijë. Pas vdekjes së saj, Hughes mori të drejtat e shkrimeve dhe dorëshkrimeve të poetes dhe botoi përmbledhjen e dytë me poezi, *"Ariel"*. Ndër vargjet e *"Ariel"* zbulohet gjendja e paqëndrueshme mendore e Plath-it dhe vullin e emocioneve që ndiente në këtë përballje të fortë me veten. Përmes kësaj përmbledhjeje, ajo eksploroji hollësisht jo vetëm veten, por edhe shoqërinë në përgjithësinë dhe veçantinë e saj. Poema të tjera si *"Daddy"* dhe *"Lady Lazarus"* trajtuan

dinamikat e pushtetit mes burrave dhe grave, duke ekspozuar kësaj shtypjen dhe konfliktet e brendshme që gratë ndiejnë teksa përpiqen të balancojnë pritshmëritë shoqërore me ato personale. Veprat e saj u folën shumë njerëzve, duke nxjerrë në pah abuzimet mendore dhe duke i dhënë vlefshmëri rrjedhës së paqetë të arsytimit që i shoqëron ato.

Ndikimi që ajo pati ndihet ende edhe sot. Plath jo vetëm që ndikoi ndasitë sociale, duke u dhënë dritë padrejtësive edhe në institucioneve moderne, por po ashtu ndikoi në ngritjen e cilësisë së letërsisë amerikane.

Ajo zhvilloi atë stil shkrimor që njihet si *Letërsia rrëfimore*, një stil i ri që përbashkon ndjesitë personale me ato sociale dhe kolektive, duke reflektuar kështu problemet më të thella të shoqërisë. Përmes letërsisë së saj Plath gjithashtu u dha zë lëvizjeve feministe me refuzimin e saj të vazhdueshëm të normave tradicionale gjinore.

Me përfundimin e leximit të Kambanës së Qelqtë, e ndjeva veten më afër kuptimit të vuajtjeve të Plath-it, dhimbjes që ajo ka përjetuar, ndonëse nuk do t'i kuptoj kurrë plotësisht përvojat e saj. Fjalët e saj janë fjalët e mia dhe arritën t'i vërtetonin ato mendime të brendshme, duke larguar nga vetmia që i shoqëron kaherë. Shkrimet e saj kanë bërë të njëjtën gjë për shumë të tjerë, duke sjellë një ndjesi qetësie në kohë trazirash emocionale dhe pasigurish.

Sot kujtojmë një shkrimtare që jo vetëm luftoi brenda vetes, por edhe theu barrierat, duke trajtuar çështje që të tjerët nuk i preknin dot dhe duke hapur rrugën për shkrimtarët e ardhshëm.

Sot përkujtojmë Sylvia Plath...

11 shkurt, 2022



Në një botë që mbetet thellësisht e polarizuar, tmerrësisht e politizuar, e fragmentarizuar nga pabarazia dhe luftërat, dhe nga mizoria që jemi në gjendje t'i shkaktojmë njëri-tjetrit dhe tokës, shtëpia jonë e vetme, në një botë kaq të trazuar, çfarë mundën shkrimtarët dhe poetët qoftë edhe të shpresojnë për të arritur? Çfarë vendi mbetet për historitë dhe imagjinatën kur fanatizmi, shkatërrimi dhe thirrjet për asgjësimin e kundërshtarit shqiptohen me zë të lartë dhe me guxim? Nëse mund t'u kthej pas në kohë, kushdo që ka njëfarë moshe do të kujtojë se jo shumë kohë më parë, në një moment tjetër në histori, kudo mbizotëronte një ndjenjë e fortë optimizmi. Muri i Berlinit kishte rënë. Bashkimi Sovjetik ishte shpërbërë. Njerëzit flisnin për "triumfin e demokracisë liberale". Ekzistonte një hipotezë se tani e tutje historia mund të lëvizte vetëm në një mënyrë drejtvizore dhe gjithmonë përpara. (Ndërsa për ne, rrëfimtaret e historive, koha nuk lëviz në mënyrë drejtvizore. Kur shkruan histori, ndien se koha mund të shkojë prapa dhe përpara, dhe ndonjëherë mund të krijojë rrathë.) Në fund të viteve 1990 dhe në fillim të viteve 2000, optimistët më të mëdhenj dolën nga fusha e teknologjisë. Ata na thanë se falë përhapjes së teknologjive digjitale, informacioni do të përhapej lehtësisht kudo dhe njerëzit do të bëheshin qytetarë të informuar, do të merrnin vendime mbështetur në informacion, dhe kështu demokracia do të ngadhëjente kudo. Por informacioni dhe dija nuk janë e njëjta gjë ashtu si dija dhe urtësia nuk janë e njëjta.

Duke rendur përpara, sot po jetojmë në një botë në të cilën ka shumë informacion, por pak dije dhe akoma më pak urtësi. Fragmente nformacioni vërshojnë mbi ne çdo ditë. Ndërsa lëvizim lart e poshtë ekranit, më shumë nga zakoni, nuk kemi kohë të përpunojmë atë që shohim. Nuk ka kohë për të përthithur, reflektuar apo për të ndërjet. Hiper-informacioni na krijon iluzionin e dijës. E vërteta është se ne kemi harruar prej kohësh si të themi, "S'e di". S'i shqiptojmë më këto fjalë. Nëse nuk e dimë përgjigjen për diçka, për ndonjë gjë, thjesht e kërkojmë në gugëll dhe jemi në gjendje të themi disa gjëra, por kjo nuk është dije.

Për të përvetësuar dije të vërtetë, duhet të veprojmë më ngadalë. Na duhen hapësira kulturore, festivale letrare, një shkëmbim i hapur dhe i ndershëm intelektual. Na nevojitet gazetari e që nuk rend. Na duhen libra.

Dhe pastaj është urtësia. Urtësia kërkon që punën ta bëjmë me zemër ashtu si edhe në bisedat tona. Duhet të ndërtojmë inteligjencën emocionale. Kemi nevojë për empati. Kemi nevojë për letërsi.

Tani nuk po them se ne shkrimtarët jemi njerëz të urtë. Nuk jemi. Ajo që po them është se kur shkruajmë histori të trilluara lidhemi me diçka më të madhe, më të vjetër dhe patjetër, më të urtë se ne. Dhe kjo diçka është arti dhe zanati i lashtë i të rrëfyerit. Është universal. Nuk i përket asnjë fisi, krahine apo feje. Nuk mund të kufizohet me asnjë lloj kufiri.

Si romanciere, jam thellësisht e interesuar për ekofeminizmin, i cili synon të krijojë lidhje midis çështjeve në dukje të ndara. Për shembull, sot, nga dhjetë vendet me mungesë uji në



# Elif Shafak

## Fuqia e letërsisë dhe të jesh shkrimtar në "Epokën e ankthit"

Revista letrare Lithub, 22 tetor 2024

Përktheu: Granit Zela

botë, shtatë janë në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut. Lumenjtë tanë po vdesin. Gratë, në mbarë botën, janë bartëse të ujit. Kur nuk ka burim uji aty pranë, largësia që duhet të përshkojë një grua e re rritet, duke rritur fatkeqësisht edhe gjasat për dhunë gjinore. Pra, nëse ka rëndësi çështja e mungesës së ujit, duhet të ketë rëndësi edhe çështja e pabarazisë gjinore, nëse i kushtojmë rëndësi pabarazisë gjinore, duhet t'i kushtojmë edhe pabarazisë racore, etj.

Mendja letrare nuk mund të jetë izoluese. Arti i rrëfimit të historive ka të bëjë me krijimin e lidhjeve.

Si shkrimtarë, ne i adhurojmë historitë, sigurisht, por ne jemi dhe duhet të jemi po aq të interesuar për atë që lihet në heshtje. Kushdo historia e të cilit është fshirë, është shtyrë në ndonjë periferi dhe është harruar, kushdo që është bërë të ndihet si "Tjetri", bën që zemrat dhe stilolapsat tanë të lëvizin vetvetiu në atë drejtim.

Letërsia e sjell periferinë në qendër dhe njerëzton ata që janë çnjerëzuar. Kjo është arsyeja pse rrëfimtaret e historive janë ruajtës të kujtesës.

Për romancieren Toni Morrison, lufta, beteja e ashpër midis kujtesës

dhe harrësës ishte diçka që e motivonte rrëfimin. Ajo shkroi për "historinë përballë kujtesës dhe për kujtesën përballë mungesës së kujtesës".

Pjesa më e madhe e historisë që na mësohet në Turqi është *historia e tij*, që do të thotë historia e disa burrave në pozitat e pushtetit dhe autoritetit – si Sulltanë. Si ishte jeta në Perandorinë Osmane për gratë? Ku janë historitë e grave? Heshtje. Si ishte jeta për pakicat – për një fshatar kurd, një argjendar armen, një mullixhi hebre, një fermer arab, një marinar grek... Heshtje. Pra, si shkrimtarë, duhet të gërmojmë thellë nëpër shtresa të historisë dhe amnezisë për të zbuluar histori të patreguara.

Ne duhet gjithashtu të lidhim kulturat e shkruara dhe ato orale.

Në epokën e hiper-informacionit, e kënaqësisë së menjëhershme, e konsumit të shpejtë dhe të shkatërrimit të klimës, letërsia është dhe duhet të jetë një akt shprese. Dhe rezistencë. Rezistencë jo përmes forcës, por përmes aftësisë për të na kujtuar njerëzimin tonë të përbashkët.

Autorja Doris Lessing dikur e përshkroi me elokuencë letërsinë si "analizë pas ngjarjes". Unë e kuptoj fort mirë. Gjërat ndodhin dhe shkrimtarëve u duhet kohë për ta përpunuar dhe më pas shkruajmë në mënyrë prapavështruese, me vonesë.



Megjithatë, sot kemi hyrë në një botë të re. Në këtë moment në kohë kur jemi dëshmitarë të kolapsit mjedisor dhe luftërave, polarizimit në rritje dhe zgjerimit të pabarazive dhe ndalimeve të librave, teksa dëshmojmë paafësinë tonë për të mësuar nga historia, në këtë udhëkryq të rëndësishëm, letërsia duhet të jetë jo vetëm analizë pas ngjarjes, por edhe analizë *gjatë* ngjarjes.

Por si mund të gjejmë vullnetin për të vazhduar të shkruajmë histori në këtë Epokë Ankthi? Si mund të kemi besim te librat dhe aftësia e tyre për të ndryshuar botën? Sepse është e lehtë të humbasësh vullnetin. Në Lindje Perëndim, Veri dhe Jug, ngado që të ktheni sytë, do të shihni se njerëzit janë në ankth. Të rinjtë dhe të moshuarit. Të gjithë janë të prekur nga ankthi ekzistencial, i vetmi ndryshim është se disa njerëz janë më të zotë për ta fshehur këtë ndjenjë.

Pra ka Ankth. Zemërim. Mlllef. Inat... Është një epokë në të cilën emocionet udhëheqin dhe drejtojnë politikën. E gjithë kjo është sfiduese, por nëse ka një emocion që më frikëson, është mungesa e të gjitha emocioneve. Është mpirja.

Unë besoj se kjo botë do të jetë një vend më i rrezikshëm dhe më i keq për të jetuar nëse do të shndërrohej në Epokë të Apatisë. Nëse reshtim së kushtuari rëndësi asaj që ndodh sot, reshtim së shkruari dhe së foluri për atë që po ndodh në Gaza, në Ukrainë, në Sudan... Nëse bëhemi të pandjeshëm, të vegjël, indiferentë dhe të mpirë. Kjo ishte ajo për të cilën na paralajmëroi filozofja Hannah Arendt.

Letërsia është antidoti i mpirjes. Shkrimtarët nuk mund t'i ndalin luftërat. Ne nuk mund të bëjmë që urrejtja të zhduket. Por mund ta mbajmë të gjallë flakën e paqes, bashkëjetesës dhe empatisë. Fuqia e letërsisë na kujton për atë që jemi të aftë, jo vetëm për shkatërrim dhe ndarje, por edhe për bukurinë, solidaritetin, bashkimin dhe dashurinë.



Mbi fletoret e shkollës  
Mbi tavolinën time e mbi pemë  
Mbi rërë të thatë e mbi dëborë  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi çdo faqe libri të lexuar  
Mbi të gjitha kanavacat bosh  
Mbi gurë, gjak, letër a hi  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi përfytyrimet e arta  
Mbi armët në duart e ushtarëve  
Mbi kurorat e mbretërve  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi xhungël e shkretëtirë  
Mbi fole e driza  
Mbi kujtimet e fëmijërisë  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi mrekullinë e netëve  
Mbi bardhësinë e ditëve  
Mbi stinët e dasmave  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi teshat e kaltërta  
Mbi moçalet e shndritshme prej diellit  
Mbi liqenin e gjallë të hënuar  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi fusha e horizont  
Mbi pendët e zogjve  
Mbi mullinjtë e hijeve  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi retë e pambukta  
Mbi furinë e stuhisë  
Mbi shiun e zhurmshëm e të hesh-tur  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi figurinat vezulluese  
Mbi tingujt e ngjyrave  
Mbi të vërtetën e natyrës  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi shtigjet e larta  
Mbi rrugët e gjera  
Mbi sheshet që gumëzhajnë prej turmave  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi llambën që po lëshon dritë  
Mbi llambën e fikur qëkur  
Mbi mendimet e mia të përbash-kuara  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi frutin e ndarë më dysh  
Mbi pasqyrën dhe strehëzën time  
Mbi shtratin tim porsi një guaskë të zbrazët  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi qenin tim trazovar e të përkëd-helur  
Mbi veshët e tij të ngritur përpjetë



PAUL ELUARD

## Liri

*përktheu Dr Bledar Kurti*

Mbi çdo dorë që më shtrihet  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi habinë e surprizave  
Mbi buzët që presin puthje  
Mbi asgjënë më shurdhe se heshtja  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi rrënojat e strehimores sime  
Mbi fenerët e mi të rënë përdhe  
Mbi terrin e mërziisë sime  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi mallin pasion-shuar  
Mbi vetminë lakuriqe  
Mbi marshimet e vdekjes  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi përtëritjen e jetës  
Mbi rrezikun e kaluar  
Mbi shpresën pa të shkuar  
Unë shkruaj emrin tënd

Përmes fuqisë së një fjale  
Unë vij në jetë përsëri  
Sepse kam lindur për të të njohur ty  
Për të shqiptuar e nderuar emrin  
që të takon  
LIRI

Mbi putrat e tij të mprehtë  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi flakët e zjarrit bubulak  
Unë shkruaj emrin tënd

Mbi pragun e derës sime  
Mbi orenditë plot nostalgji

Mbi butësinë e lëkurës  
Mbi vetullat e miqve të mi



Fotografitë nga Dr Bledar Kurti



## “EXLIBRIS”, BEN BLUSHI DHE MARINGLEN KASMI JANË FITUESIT E EDICIONIT TË PARË TË ÇMIMIT “SAMI FRASHËRI” DHËNË NGA BASHKIA E BELSHIT

Këshilli bashkiak i Bashkisë së Belshit ka themeluar një çmim me emrin e Sami Frashërit, ideologut të Rilindjes sonë Kombëtare për arritjet në letërsi, albanologji dhe publicistikë.

Më 31 tetor 2024, u nderuan fituesit e edicionit të parë: gazeta “ExLibris”, shkrimtari Ben Blushi

për romanin “Komploti” si dhe historiani Maringlen Kasmi për librin “Wilhelm Zu Wied dhe Shqipëria”

Fituesit shprehën mirënjohjen për kryetarin e bashkisë së Belshit, z. Arif Tafani dhe jurisë me anëtarë prof. dr. Viola Isufaj, prof. Dr. Gëzim

Hoxha, kompozitori Naim Gjoshi, studiuesi dhe shkrimtari Behar Gjoka, me kryetar shkrimtarin Namik Dokle.

Ky çmim do të jetë i përvitshëm dhe do të shpallet në datën 1 qershor, kur është ditëlindja Sami Frashërit.



### Çmimi Sami Frashëri për Publicistikë:

I jepet botuesit Bujar Hudhri për gazetën “ExLibris”: “Gazetë me autoritet të veçantë, me gjuhë të pasur dhe shprehëse; një enciklopedi kulturore, letrare, publicistike dhe analitike, plot freski dhe elegancë.”



### Çmimi Sami Frashëri për Studime Albanologjike:

I jepet studiuesit Marenglen Kasmi për librin “Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria”: “I paisur me dije të konsoliduara historike, me material burimor arkivor origjinal, sjell për herë të parë një monografi të Princ Vidit, duke paraqitur një segment kohor të ndërlikuar nga historia e Shqipërisë.”



### Çmimi Sami Frashëri për Letërsi:

I jepet shkrimtarit Ben Blushi për romani “Komploti”: “Një roman që projektonte distopinë e së ardhmes nëpërmjet ndërthurjes së narrativës, sendërton një dialog domethënës, alogjik me antikohën.”